

Kur iu vura kërkimit të origjinës, pemës familjare, e kuptova se jo vetëm im atë, por edhe ime më kishte prejardhje nga Shqiperia, nga Leksoviku. Edhe poetët më të mëdhenj të turqishtes time kanë qenë bashkëvendasit e mi: Memet Akif Ersoji, i cili shkroi marshin e pavarësisë dhe Shemsedin Samiu, autori i romanit të parë turk.

ONUR CAYMAZ: *Të gjithë lexuesit e mi shqiptarë i kam kushërinj të largët*

TREGIME SI FLIRTE TË PABESUESHME

nga Xhevair Lleshi



(fq. 2)

-In memoriam për Ndoc Gjetjen,
në 10 vjetorin e vdekjes-

GJITHMONË DIKUSH KUJTOHET PËR POETËT ...

nga Salvador Gjeçi (fq. 17)

Refleksione mbi librin “Çamëria, toka pa njerëz, njerëzit pa tokë” të autorit Hyqmet Zane

Nga Prof. Dr. Emine Sadiku (fq. 14)

Romani “Koncert në fund të dimrit”

RRËFIMI PËR KINËN, NË FAKT, ËSHTË NARRATIVA PËR KOMUNIZMIN SHQIPTAR

Prof. As. Dr. Ilir Yzeiri (fq. 6)

TEODOR KEKO OSE MË MIRË DORI

ese nga Roland Gjoza (fq. 16)

MESHARI I GJON BUZUKUT (1555)

BOTIM KRITIK



PUNUAR NGA
EQREM ÇABEJ

FAKSIMIL DHE TRANSKRIM FONETIK

ÇABEJ

NGA E KA PREJARDHJEN KOPJA E VETME QË NJIHET NGA LIBRI I BUZUKUT

Dhimitër S. Shuteriqi (fq. 5)

Gjon Buzuku dëshmon se për veprën e tij punoi brenda 20 marsit 1554 dhe 5 janarit 1555. “Meshari” i Buzukut u vu, me sa duket, në indeks nga Inkuizicioni, kështu që libri u zhduk gati krejt dhe sot njihet në një kopje të vetme në Bibliotekën Vatikane. Atë s’e përmend asnjë autor pasardhës përpara Pjetër Bogdanit (1665)...

SELMA LAGERLÖF

**Fjala në festën e Nobelit
10 dhjetor 1909** (fq. 13)

LETRA QË I NDRYSHOI JETËN EMILY DICKINSON-IT



(fq. 17)

BIBLIOTEKË

Milorad Paviq (fq. 8)

*Dhoma në të cilën
zhduken hapat*

Besa Kalaja (fq. 9)

*Ai nuk frikësohej
nga vdekja*

Azgan Berbat (fq. 12)

Ndjekje të thinjura

**Fragment nga romani i ri
Kapitulli i Amerikës**

I FATOS KONGOLIT

(fq. 10)

Kur iu vura kërkimit të origjinës, pemës familjare, e kuptova se jo vetëm im atë, por edhe ime më kishte prejardhje nga Shqiperia, nga Leksoviu. Edhe poetët më të mëdhenj të turqishtes time kanë qenë bashkëvendasit e mi: Memet Akif Ersoji, i cili shkroi marshin e pavarësisë dhe Shemsedin Samiu, autori i romanit të parë turk.

Onur Caymaz:

Të gjithë lexuesit e mi shqiptarë i kam kushërinj të largët

LETËR E AUTORIT ONUR CAYMAZ, DREJTUAR BOTUESIT TË TIJ XHEVAIR LLESHI (UEGEN)

Si fëmijë, në shtëpi, veç turqishtes, herë pas here, gjyshja dhe nëndaja ime flisnin edhe një gjuhë tjetër. Ndonjë fshehtësi, thashetheme ose gjëra që me gjasë unë s'duhej t'i dëgjoja... Çuditësha, mundaheja të kuptoja. Tani asnjëra prej tyre nuk është gjallë. Çuditësha shumë! Midis fjalëve të tyre zgjateshin përtej pjergulla rrushi, piqeshin petulla, pastaj përgatitej kos me hudhra: Shqipja... Gjuha e vendit ku qenë lëruar rrënjët e mia, toka ime.

Kthesat e bukura të shqipes, pjerrinat e mrekullueshme, vajzat e bukura faqekuqe, burrat e pashëm me duar gjigante, i pata ndërë përsëri, shumë më vonë, në Durrës, me rastin e festivalit poetik Festivali Poeteka, të organizuar nga Arian Leka, me miqtë poetë në Berat, ose në një bar në Tiranë me Albana Kozeli, përkthyesen e poezive të mia, dhe gjithë duke e shtrydhur fort kujtesën, e pata vënë re, se në fakt e kuptoja pak a shumë këtë gjuhë të lashtë të Evropës, madje edhe mund ta flisja qoftë edhe një grimë.

Kur iu vura kërkimit të origjinës, pemës familjare, e kuptova se jo vetëm im atë, por edhe ime më kishte prejardhje nga Shqiperia, nga Leksoviu. Edhe poetët më të mëdhenj të turqishtes time kanë qenë bashkëvendasit e mi: Memet Akif Ersoji, i cili shkroi marshin e pavarësisë dhe Shemsedin Samiu, autori i romanit të parë turk.

Kurse kjo është një gjë krejt e re: Arbana Rexhepi e njoha para një viti, falë një e-maili që ajo më dërgoi. Më shkruante se sa shumë i pëlqente shkrimet e mia. Sa mirë që e fliste turqishten. E këtillë është jeta, e çuditshme, me kësolloj pikëtakimesh të çuditshme. Më pas, Arbana përktheu një tregim timin që u botua në revistën letrare illz - Revistë letrare e Tiranës. "Po sikur të përpilojmë një libër", tha, kur i erdhi dita: "E gjej unë shtëpinë botuese"...Një pikëtakim tjetër: Xhevair Lleshi dhe familja e Uegen Shtëpia Botuese. E si mund ta harroj shkrimin tërë mirësjellje që zotëri Xhevahiri shkroi në fund të librit. Tanimë zëri im tjetër, mbetur nga shumë larg, nga paraardhësit e mi, takohet me lexuesit e mi shqiptarë, pra, me kushërinjtë e mi të rinj të largët. Të gjithë lexuesit e mi i kam kushërinj të largët; kurse të shkruash është ta sfidosh vdekjen. Atëhetë, le t'i mbjellim farat edhe një herë, në një gjuhë tjetër; bashkë, të gjithë së bashku. E di, shpirtërat tanë paskëshin qenë të pavdekshëm...Tregimet e mia janë tani me ty, përshëndetje, shqipja ime e bukur. Me gotën në dorë, përshëndetje! Gëzuar!

8 qershor 2020

TREGIME SI FLIRTE TË PABESUESHME nga Xhevair Lleshi

Onur Caymaz, shkrimtar i ri turk me origjinë shqiptare. Një libër me tregime: «Dashuria, asgjë...»Përkthyer nga e talentuara Arbana Rexhepi (Shkup). Një libër që rrjedh ëndshëm. E sheh nga larg: si njolla në telajo, hije, por gjithçka galduese. Ende dëgjon në veshë buçimë zërash, dridhje të lehta, shpërthime, gudulisje, britma, të qeshura... Në vetminë tënde vinin përqark hijet e personazheve. Mungonte vetëm mikrofoni pranë gojës dhe pastaj ato

mërmërimat e zakonshme të jetës së përditshme, të rrethon një dashuri ndryshe, që pluhuron dhe bëhet... asgjë, me skenat e një filmi të harruar po edhe këta nuk mjaftojnë. Se fjala kthehet në mit. Dhe lëvizin në mënyrë jo skematike njerëz, plaçka, kollitje, mure, trupa kokallë, dhimbje të thella, bukuri që të lënë pa mend dhe përplot frymë poetike. Pse pak ju duket qoftë edhe kjo frymë, në metafora që shndrisin dhe të krijojnë gjendje të forta emocionale, njerëz të çuditshëm si në rrëfenjat e lashta që zbesin në tokë e nuk të lënë as të mbushesh mirë me frymë, ndoshta edhe të shtyjnë me forcë drejt korridoreve të tjera të fjalës së bukur e të mençur me prerje të forta e në flirte të pabesueshme. Herë-herë pranë teje dikush që frymëzon, një tjetër që jep shpirt dhe të kërkon ndihmë, të tjerë, të pashpirt sigurisht, të belbëzojnë mençuri tronditëse në çastet e fundit...



Tregimet e Onur Caymaz-it janë meditime të holla e të thella psikologjike, gjendje të forta e kapitëse. Të shoqëruara nga mendime të holla, duke ecur gjithnjë në tërësi të thikës, në një shprehje që të frymëzon e të krijon gjendje. Të duket se ti mbreh «kaun e arës» dhe e ndihmon atë, meqë është në gjendje të vajtueshme, për ta punuar vetë atë, nganjëherë të hysh në lëkurën e personazhit që mendon e mendon pa fund rreth ndarjes me njeriun që do, që, i divorcuar, kthehet mbrapsht dhe ecën para, këmbëngul më kot, lodhet pa fund, bërtet e s' dëgjohet askund... Njerëzit janë dhe nuk janë kudo. Të mbytet duhma e tyre e përvuajtur, një zjarr që s'të ngroh, po edhe këndellesh nga pak kur mendon se sheh diçka që të shëmbëllen si zjarr. Veç kudo gëlojnë nëpër dritë po edhe në errësirë, më fort si hije nëpër mure, po prapëseprapë të mbetet të thuash se janë të lumtur që ndihen të lirë. Le të jetë ndjesi e largët. Personazhe të vërtetë e të gënjeshtërt që të afrohen e të pëshpëritin, ku edhe i merreshin vesh edhe jo mendimet, ku bëjnë atë që u thonë dhe nuk thonë kurrë atë që bëjnë, ku fryn gjithnjë briza e hollë e mendimit. Vijnë dhe ikin. Hyjnë dhe dalin. Veç gjithnjë frymojnë, i presin «drutë» shkurt...

Të gjitha tregimet kanë një frymë emocionuese e përplot art. Të mjerët njerëz, ndonëse të shoqërojnë me humor dhe tregohen të guximshëm, të nxjerrin jashtë nga binarët, zhduken e duken menjëherë, s'dinë ku ta çojnë tërë atë bukuri, zgjuarsi e mirësi, kurse herë të tjera thyjnë keq veten, tallen, shfryjnë, këndojnë, hedhin valle, ndrydhen, turpërohen, ndukin mustaqet a fërkojnë mjekrën, me një fjalë s'dinë ç'bëjnë. Ata, personazhet e Onur Caymaz-it e ndjekin plumbin, nuk harrojnë kurrë, e gjejnë të vërtetën, bashkëjetojnë me gjendjen e rëndë, janë gati të vetëvriten, po kush i beson? I beson thua ai (ajo) që tallet me ta (to)? Duket sikur diku fjalët shkurtohen, prishen gjendjet mendore, madje sikur i përmbys shkallimi, nuk e lënë të kaluarën dhe sikur e mbajnë më pranë se s'duhet, nuk e nxjerrin dot qimen nga qulli, që shohin përpara dhe nuk lejojnë mendim tjetër të pipëtijë. Sigurisht ka prej tyre që tregohen fanatikë, ekstremistë, që s'pyesin për njeriun, as për ide, që e kanë lidhur pronën me shpirtin, që munden e fitojnë, që të betuar për kauzën luftojnë, që e shohin veten edhe si mostër po edhe si engjëj, të humbur e të shuar, që shohin larg, dëgjojnë dhe reflektojnë gjersa vjen gjithnjë një ditë dhe kuptojnë të vërtetën e thjeshtë, se bëhen të famshëm edhe të rrethuar nga gjërat e thjeshta e të vogla, sikur rrojnë dhe nuk rrojnë, që nuk i tremben asgjëje, se e pranojnë dënimin, ndërsa të tjerë të mjerë gjer në thelb rronte me frikën e imët të dënimit përditë. E vërtetë: këta personazhe të kohës dalin nga apartamentet apo dhomat e hotelit siç dilnin dikur nga kasollet andej nga skërkat e Anadollit dhe vijnë e përplasen në Stamboll, në metropol.

Dhe përmes mendimit të tyre gërries ti sheh

gjendjen e vërtetë psikologjike edhe në përshkrimin e perëndimit e diellit apo lindjen e tij. Duket sikur nën rreshta të thonë se ndihen mirë në qendër dhe i gëzohen pijes së fshehtë në periferi. Gjithçka e thjeshtë dhe me një humor të fshehtë (por jo tallës) vjen dhe rri pranë teje në shitoret e mrekullueshme të Pazarit të Vjetër, po edhe në një hotel luksoz, aq pranë, kur dielli shkon e mbytet në det. Dhe lexuesi mbyll në dorën e ashpër atë që i mungon shumë. E ndjen se makuti është aty dhe të pëshpërit ndërsa ti ia dallon frikën. Se ti natyrisht që je më i fuqishëm, ke më shumë zemër e dashuri. Dikush prej tyre hap dorën, këqyr një grimë vajzën moderne por krejt të vetmuar, që bëjnë përshtypje, që i bie në sy halli te zbehtësia e fytyrës dhe po aq te mungesa e oreksit, te shenja për të dalë. Atje shikon diellin e madh të korrikut teksa nxjerr syrin befas nga një hapësirë përmbytur nga mjegullnaja e qumshtët apo kur humbet krejt në det. Vajza godet vetëm me shpirt dhe, befas dëgjohen thirrje histerie, këngë, valët e një furie dalldisë, madje duket se rretheqark saj njerëzia kishin pirë me grushte eliksir dashurie. Dhe mos harroni asnjëherë: në dhomë apo kudo të jesh bredhin hijet nëpër mure dhe bëjnë zjarr të fshehtë që buron me siguri nga shpirti i dikujt.

Duket se çdo gjë në këto tregime është pagëzim pa foshnje. A e shikoni gjëkund foshnjën e lirisë së munguar? Jo, sepse kjo është një imagjinatë. Dhe kurdoherë luhet me fjalët, me fjalinë e shkurtër, me aforizmin dhe një deduksion e mbledhur grusht. Aty-aty bëhet gjak po befas kjo nuk ndodh, me një të papritur të këndshme, diku tjetër lidhet një marrëveshje e heshtur apo diç fshihet pas kulisave. Shumë më vonë renditen dhe dalin faktet, po rrugën e lirisë e sheh të sakatuar dhe të vështirë. Dhe ta besosh që njerëzit ia kanë mbushur mendjen vetes se ndihen të lirë. Ka plot situata rrëqethëse, aq sa të duket se ke aq pranë personazhe të tragjedisë. Personazhe që duket se e kanë hedhur pas krahëve, me tallje e përqeshje, të djeshmen dhe i ndruhen të sotmes duke përcjellë me hap funebër të kaluarën. Po e ardhmja? Ku është fshehur? Ku bëhet e ardhmja?...

Duke lexuar ti thua se kemi aq shumë ngjashmëri aq se mendon se kemi të bëjmë me recidive, se kjo është spiralja e jetës, herë-herë edhe e lirë, që shfaqet përdhunshëm dhe se ashtu përhumbshëm bëhet edhe mbjellëse e një doktrine të largët e me thellësi shpirti. Një herë tjetër mendon se personazhet janë të zgjedhur, se vënë dhe heqin paruke, se bëhen papritur aq të ngjitur, se i ngajjnë dikujt që është pranë teje, përditshëm, kur situatat komike i kthen në tragjike, natyrisht që dalin nga manteli që i hapen paksa monumentit te sheshi i madh. Të duket se këlyshët do të bëhen qenë e duke u kacafytur për fron dhe ky fron është pranë teje i kredhur në gjak. Populli ecën në rrugë në çdo situatë, ndizet, fle, punon, heshtet, këndon dhe gjithë i përfytyruar, i kudondodhur, i palodhshëm, me besimin e verbër që të çon në skllavëri, populli që përdoret i ndarë dhe që frymon kurdoherë bashkë, i tërhequr ngadalë në skaje të vështira ku ndihet dhe duket përplasja, ku forca që do të pjellë të mirën dhe të keqen dhe ndërkaq liria herë fshihet dhe herë degjeneron prej frikës dhe terrorit. Kështu e shoh të përshkruar situatën në gjendjen e një personazhi të Caymaz-it se çdo të vijë nesër e pasnesër, duke rrjedhur bashkë me ujërat e smeraldtë të shpitrave të vetmuar e të braktisur, te Thjeshtura apo te Vajza, apo tek modeli që dashuron dhe i kthehet e gjitha në një Asgjë të madhe teksa diku tjetër profetizohet kalvari që heq e vuan njeriu i shkretë. Këtyre njerëzve duket se u ka ardhur fatura e nderit dhe ata s'kanë rrugë tjetër veçse ta paguajnë. Janë pikërisht ata që shërbehen dhe kërkojnë falje, që tërhiqen, të paktën për një çast, që ndërtojnë edhe një histori biblike, një histori me një plak, një profet, që vjen i pari, që do dhe kërkon me një magji të pashoqe diçka se e ka lënë e dashura dikur. Jo, duhet të dashurosh përsëri. Dhe i vjen ndërmend se kështu fiton jetën dyfish dhe më i plotësuar...

Dhe e ke përherë pranë mentalitetin e heronjve të tregimeve. Aty është mendimi edhe i liderit dhe edhe i asaj që me pa të drejtë këtillohet si fundërrinë. Nga ky duhet pasur frikë. Dëgjoni: në Greqinë e lashtë, në Athinë... Por le ta lëmë më mirë, se po t'i ktheheshim lashtësisë do humbiste edhe e djeshmja edhe e sotmja dhe s'do gjenim vend për të ardhmen...

Tregime nga Onur Caymaz

ERA E JUGPERËNDIMIT

Në mesjetë, kurdô që piktorët vizatonin ndonjë hartë, të dashurat e tyre u thoshin: «I dashur, a nuk e vizaton këtu një ishull për mua, le të bëhet ai ishull, imi.» A nuk bënim edhe ne të njëjtën gjë kur ishim fëmijë? Makina e parë që do të kalojë në rrugë, është e imja, kënga që do të fillojë tani, le të bëhet e jotja; nëse nga qielli bien tri mollë, njëra i përket rrëfyesit, tjetra dëgjuesit... Mirëpo, e gjithë kjo lojë e këndshme, a nuk ngjan pak e çuditshme kur bëhet fjalë për një ishull? Pa mendoni një herë ishujt prej fantazme nëpër harta, ishujt që në të vërtetë s'i gjen kund. Një admiral i famshëm anglez, teksa po kthehej rrugës nga Spanja për në Angli, po shqyrtonte një hartë që i pat rënë në duar. Në njërin nga ishujt që kishte parë në hartë, kishte menduar të ndalonte dhe të mbushte ujë. Marinari i burgosur spanjoll, që ndodhej në anije bashkë me të, i pat dhënë këtë përgjigje pyetjes së admirali rreth ishullit në hartë: «Nuk besoj se do të mund ta gjeni, zotëri, ky ishull është vizatuar për hir të një sinjore.»

Në të vërtetë, një ishull është një lloj vetmie, një gjë ndjellakeqe. Një lloj uturime. Dritë që kullon prej gjetheve, hënë e plotë fantazore në pasqyrën e pajtonit. Krifat e rrufeshme të kuajve... E vërtetë ose gënjeshtër, erërat na rrëfejnë se nuk ka shtegdalje nga një ishull... Le të jetë kjo erë jugperëndimi. Syri i erës së jugperëndimit është i ujshëm, thoshin të moçmit. Erë që sjell lagështi, nënkuptonin; fill pas saj bien shira fluturakë. Në Stambollin e moçëm, në ditët me erë jugperëndimi, kadinjtë nuk dilyn në gjyq, vaporët iu afroreshin skelave gjithë naze. Era e jugperëndimit e sjell aromën e detit në hundë si të qe një shamizë e ngjyer me kolonjë. Shpërthen në valëthyes. Fluturon flokë. Lëngëzon sy. Mbart me vete zëra, një zë shumë të vjetër zileje, pallmën e gomarit të lodhur të kopshtit të pasmë, vikamën prej ëndrrash dhe kanelle të bozaxhiut në netët e përborura të dimrit; përse jo? Këtë natë, era e jugperëndimit përkëdhel fjalët e çiftit që po grindet atje në kodër, në derën hyrëse të vilës romake, në dritën e zbehtë të llambës. Gruaja është bionde, burri zeshkan dhe nuk do të ndahen. Sepse do të shohin ditë të tjera bashkë. Njerëzit bëhen një për të parë bashkë, e jo ndarazi. Në brendi të njeriut përkunden anije. Të thuash erë jugperëndimi, do të thotë të qëndrosh edhe një natë

në ishull. Nuk ka shtegdalje, përsëri!

Një poet nga bregu përkarshi, erën e jugperëndimit e përshkruan si «era që e ndan mishin nga ashti»; *notias* në greqisht. Edhe Tanpënari diku në njërin nga ditarët e tij ankohet se «edhe me ndihmën e erës së jugperëndimit s'mund të bëj gjë». Është njëherazi edhe fatkeqësia edhe shija e Bizantit bastard. Edhe Nazimi ka një poezi me titull *era e jugperëndimit*, midis vargjeve të së cilës, në burg, në furtunë, përplasjet dera e hapur e birucës së tij. Për aq sa era e juglindjes është gri në blu të thellë, aq edhe era e jugperëndimit është blu në të zezë.

Ku je lulja e erës me të cilën në shkollë fillore i mësova drejtimet e erërave? Je edhe erë, edhe lule; sa emër të bukur që paskë! Më ngjaje si kristalet në fjalat e borës. Njihja mëngjese me erë, mëngjese me borë. Qytezat verore të braktisura drejt vjeshtës, shezlonët e mbetur në plazh si të vdekur, zhavorr i vetmuar, kërmill deti pa fund e krye, kabinat e veshjes të zbrazura, jehona zërash, pasqyrime dritash të ngelura nga vera e kaluar që flenë në muret e kazinove prej fantazme. Kalendar që ecën drejt dimrit, drejt mëngjeseve të errëta kur zgjimi është i vështirë. Bashkë me erën e jugperëndimit më ndërmendet edhe pluhuri i shkumësit. Sardelet në skarë, qielli i shndritshëm dhe i larmishëm që pasqyrohet nga sardelet; në qiell, në fytin tim yje me cepa të mprehtë...

Kur ta mendosh, e dashur, më parë paskësh pasur njerëz të varfër që për punë paskëshin pasur të mblidhnin gjërat që era e jugperëndimit i hidhte sa andej këtej. Ora tavoline të hedhura në breg, antena, fenerë, syze; triko, sutjena, pallto që shkëputeshin nga telat ku ishin varur dhe fluturonin në ajër; kryqe të mbetur nga mesjeta, mbledhës trishtimesh, pusulla; njerëz që në vendet e cekëta, midis rërës, kërkonin gjëra të fundosura. Ajo klasë e hollë të diturish që nxirrte në shesh gjithçka!

Era e jugperëndimit është ajo grua e bukur që hidhet me vërtik në rrugë nga romani i atij shkrimtarit të çmendur, që shkruan duke i qepur fletët me njëra-tjetrën. Sillet rreth e rrotull, gjithë përkujdesje, fustanin me tyl të pistë; sytë të ndritshëm, flokët të shpupurishur; shndrit dhe shuhet sakaq në trishtuar, këpucët boshe në vezullim. Luleshitësit janë të trishtuar, këpucët boshe në shtëpitë e peshkatarëve që u hapën në det dhe nuk u kthyen më; salepxhinjtë janë xhelozë, pjekësit e qiqrave me një përhumbje lejla; furrxhinjtë janë të përgjumur, çirakët kolliten në çmendina, dhimbje e hollë... S'e duroj



dot kollën e fëmijëve. Sikur të isha një balonë, them me vete, të zvarritesha, të më merrte era përpara. Edhe këtë natë jemi në ishull, me bukën tonë, verën tonë dhe ti, je shpirti im. Je shpirti im them, madje ka edhe erë jugperëndimi...

Jam në ishull pra, vilën romake e paskan bërë hotel. Nënkresa të pastra, s'kam gjumë, por deti është shndërruar në një bojë të zezë shkrimi. Në ëndërr jemi në anije, era e jugperëndimit na lëkund, para *Sarajburnut* dua të të prek. Duart i kam të njollosura... Sikur të frynte edhe një herë, ta ngrinte në hava e ta fluturonte gjithë qytetin. Krahët i passke mbështetur në parmakë. Ka hënë. Sikur të vija e të të përqafoja. Pa u ndrojtur. Sikur asnjëri t'mos trembej prej asgjëje. Ka hënë. Era e jugperëndimitshkund, lëkundemi. Por ama nuk rrëzohemi. Fryn, drejt e nga deti; është mbrëmje, jam vetëm, po dal në Gjylhane, aq shumë fryn sa në hundë ma sjell aromën e kafesë së tharë nga *Pazari Egjiptian*; kish gjetur një palë rruzare, ma përplas në fytyrë dritën që mori nga qelibari i tyre. Jam fund e krye ti, portokalli. Emri të fillon me **a**. Emri yt që nis gjithçka. ...Jam vetëm, në çantën time të shpinës libra në lidhje me romanin që do të shkruaj, dikush e hap zinxhirin. Do të m'i vjedhë librat, jam hutuar fare. Në çastin e fundit e vërej dhe kthehem pas. Ja, kështu pra bëhem kur ti ma lëshon dorën, thotë një poet tjetër, njeri i brishtë. Vdiq dhe ai. Fundja të gjithë vdesin.

Në ballkon hënë. Në erë jugperëndimi vetëm të çmendurit dalin jashtë. I çmenduri kësisoj e gjen të çmendurin. Ajo gruaja tregimtare e çmendur, ildis letrat me njëra-tjetrën. Do të të përqafoj, në ballkon. Ka hënë... *Thonë se nën dritën e hënës druri i arrës* nuk shkundet. Jo arra, argjend më derdhet përsipër, prej teje. Njollat janë prej teje. Era e jugperëndimit dëshiron, është e uritur; shtretërit, vitet, nënkresat nuk i mjaftojnë asgjëje. «*Je shpirti im i them, kujt...*»

Këtë natë ka erë jugperëndimi. Letrat që pareshtur, vazhdimisht i qepa me njëra-tjetrën, shpërhapen në buzët e holla të jetës, si të shkatërronin gjithçka dhe ta ndërtonin nga e para... Jam në ballkon. Fryn. Fryn pa pus him...

E KALTRA E RAKISË

Pensionist i IETT- së, burrë i ndershëm, Usta Rasimi... Gruaja i pat vdekur nga kanceri. Vitin e kaluar shkoi në haxhillëk.

Vari leshtë Rasim, biro! thoshte. Dhe ky e lëshoi mjekrën e përhirtë në të bardhë. Fytyra i përngjau një dite dimri. Atë çast, ia behu vera në një blu të thellë. Vera është një letër ushtari, shfaqet papandehur, si një përrallë.

Në ditët e para të vetmisë, Ustai u bezdis ngapak. Mjekra e shponte, e djersinte; meqë përtonte të rruhej, detyrimisht u mësua me fytyrën e re: *Njeriu mësohet me çdo gjë*, Rasim, biro...

Meqë haxhinjtë e kishin zakon, mërmërinte gjëra të ngjashme me *bis...bismillah* teksa hipte në minibuse. E ku është parë të vijnë në kohë autobusët! Prapë e njëjta gjë, nuk mbërriti askund. Në të vërtetë, s'është se kishte ndonjë vend ku patjetër duhej të mbërrinte.

Mendoj të hapte një ushqimore. Me ç'parë?

Herë pas here dilte në tregun e së martës. Spinaqi i pëlqente, por pastrohej me vështirësi.

Asnjëri nuk ia ujiti lulet, u vyshkën para se të çelnin.

Nuk lau enë derisa nuk i mbeti as edhe një pjatë a tabaka e pastër.

Kur, një ditë prej ditësh, në mëngjes, te po e fshinte qilimin, ndërkohë që në radio luante Zeki Mureni, u përball rastësisht me veten në pasqyrë: edhe ti u plake, ore haxhi!

Buzëmbërmjen e asaj dite, 16 Gusht 1999, përsëri nga shpresa ose ndoshta bukuria e ditës së verës, kishte nisur t'i lyente kangjellat e ballkonit. Përrashta frynte një puhi e lehtë. Ata të katit të sipërm kishin zier çaj sherebeli, sa aromë të mirë që mbante. Në largësi, në brigjet e Byjykadasë¹, deti zhvoshkej sa ç'mundej, digjej e përflakej.

Ustai kishte vite që e kishte harruar cigaren, në të

vërtetë, jo se e kish dashur ndonjëherë. Por ama rakinë sepse e kujtonte shpesh. Përpara pasqyrës kishte një fotografi të gruas së tij.

Ndërmendi se si zbardhëllehej rakia kur e trazo-je me ujin në atë gotën e gjatë e të hollë; m'u si ditët e dimrit. U ngrit dhe doli jashtë: ç'u plakëm, *bis ...bismillah...*

E puthi dhe i mori erë fotografisë që e mori me vete; sikur të kishte pak djathë, pak qiqra... do të kishte pirë raki.

Pensionist i IETT-së.

HOMERI YNË

Duhej ulur dhe shkruar ajo luftë, gjerë e gjatë, nga e para, mendoi, sepse tanimë kanë ndryshuar edhe lufta edhe koha.

S'kam se si ta di përse dhe si ndodhën të gjitha këto, e as se si ta kuptoj. Por ja që e di, ja që mua më ra për hise historia e saj. Kishte pirë duhan për vdekje, si të qe një oxhak; më pas gjithë natën kish pirë verë. Nganjëherë i priste edhe thonjtë, i pëlqente shumë të shkonte në hamam. Ishte në Buxha. Atë ditë doli herët nga shtëpia, i përgjumur.

Qëmoti, nga Izmiri...

Iku nga vitet, ç'ju desh! Eci rrugicave të ngushta fërgëlluese të valëzuara, i mori erë shkurës së detit, diç prej myshqesh, zemra iu mbush me erë Egjeu; nuhati erën, matanë, prej gurëve rridhnin kaltërsi që nuk i përkisnin askujt.

Qëmoti, nga Izmiri...



Më larg, në kodra, kishte shtëpi ku autobusët e vegjël dhe minibusët e përbaltur ndalonin e çonin të fala, shtëpi të varfra me ca emra të çuditshëm: Shtëpi Punëtorësh, Qyteti Gjurmë...I dhembte shpirti nga të gjitha këto, një dhimbje dymijë vjeçare, si të jesh poet, diçka e tillë duhej të qe.

Duhej ulur dhe shkruar ajo luftë, nga e para. Por, prapëseprapë, them të mos e ndryshoj skenën e Priamit dhe Akilit; ngase është e përsosur. Pranë tij kaluan vajza të cilave s'ua kuptonte gjuhën, atë gjuhën që mundohej ta mësonte; djem të rinj, horra; gurë stralli, zhavorre. Sytë e mjegullt e dritëpak i vështruan të gjitha, një nga një, i mësuan të gjitha; Homeri ynë qe nga ata që kuptonin me të shikuar. Të gjithë të vetmuarit, me shumë gjasa në këtë orë niseshin për në punë. Tha se duhej shkruar, por si do t'i rendiste të gjitha këto në atë luftë të ashpër?

Po shëtiste qytetin. Te porta e stadiumit, mesa munda të lexonte, dikush kishte shkruar: «Buxhalliu e q'i njeriun në bythë». Atë moment ndërmendi Sokratin, rininë e tij, gjithë sa kishte ndodhur. Rugë që ndërfteshin në njëra-tjetrën, dyqane karficash, byzylykësh, fustanesh; kasapë, dyqane me ngjyra të freskëta ku shiteshin fruta, dritat që ndizeshin e shuheshin pa ndà, njerëzit përpara kafeneve, rrugica të ngushta që s'kishin të sosur. Atëherë e ëndërroi kopshtin e Hasan Agait si të qe një ullishte e madhe; atëherë ëndërroi male, statuja, tregje... ç'paskan bërë kështu, tha me vete, duhej t'i kishin bërë të mëdha këto, të mëdha që... rrugët, hamamet, teatrot të preknin retë.

Në pjesën e pasme të kodrës *Tëngër*, shtëpi të ngelura që nga vitet shtatëdhjetë, nga koha e pushtimit të revolucionarëve për të hapërdarë popullin. I kaloi,

janë luftëra më të mëdha këto, tha me vete, nëse do të shkruhej për to, këtë duhej ta bëja unë, ishte puna ime kjo...

U fut në një birrari të porsahapur. Nga ana e pasme, një kamerier që si duket nuk e kish marrë hisen e dritës së diellit të mëngjesit, po mbështillte byreqe. Na sill një birrë, or trim, i tha me një theks të çalë romak. Ishte fare njomëzak, gjithë duke shikuar me po atë vështrimin e tij të lëngëzuar, shkoi e i solli birrën.

- A ndodhet ndonjë librari këtej pari?

- Po, xhaxha, - i tha, duke e vështruar mjekrën e bardhë të këtij njeriu të pakohë, - është atje tej, si del nga këtu, ec pak, merre kthesën e djathtë, është dyqani i tretë nga e majta.

E mësoi përmendësh atë që iu tha. Një gjë e trazonte përbrenda pa pushim, i qe lodhur truri. E la të lirë vështrimin flladshëm në shkurën e birrës që ia sollën. Mos shiko ti, tha me vete, Agamemnoni megjithatë qe burrë king... Dhe Paridi bir zotëriu qe... Nuk na kish hije, por ç'të bënte, nuk iu bë pa mos ëndërruar për ato cicat e bardha, si dardha të Helenës, u mërzit, e pat edhe kjo punë, tha me vete.

Kamerieri u shfaq përsëri, brenda ishte errësirë. A mos doni t'ju sjell ndonjë byrek pranë birrës. Jo, *manaki mu (nënokja ime* - gr.), nuk dua, u përgjigj, i merrej goja dhe ngjante i hutuar. Pastaj djaloshi u ndal një hop, seç deshi të thoshte diçka, por në çast hoqi dorë. Por ja që nuk i rrihej pa folur: s'dua të ngjaj sikur po ju shes mend, por kini kujdes xhaxha, është vend i prishur ky, vrasin e presin. Të faleminderit nipçe, s'na gjen gjë ne, iu përgjigj. Këtë fjali e kishte mësuar dje nga një shofer minibusi.

Po sa shumë që i ngjan, mendoi kamerieri. Për një çast Homeri i kishte përngjarë me përfytyrimin që kish në kokën e tij për *Gjyshin e Etur*². Edhe shenjt i Izmirit i tillë duhej të qe, pa shihe një herë, është i gjithi xurxull edhe ai, në këtë orë në tavernë pijanecë do gjeje, e çdo gjeje tjetër, por kjo ish çështje tjetër!

Tyrbja e *Gjyshit* ndodhej në kodrën e gjelbëruar me pamje nga deti e cila një kohë pat qenë djerrinë e në të cilën më pas vajzat e shkollave të mesme profesionale patën mbjellë pemë. Koka gjelash të prerë për kurban, gra arixheshka, fate të lexuara në pëllëmbët e duarve, nga gurët, nga leshi...

Dje kamerieri bashkë me të dashurën e tij prej shumë kohësh, kishte zbritur prapë në vendin e shkretuar në afërsi të tyrbes. Ky vend qe i përshtatshëm, nuk e dinte njeri, s'dyshonte njeri... Ishin puthur. Për vdekje. Kamerieri një copë kamerieri qe, e ku kishte parë ai në jetën e tij një të urtë si kjo, një lule jargavani si kjo. Por ja që nuk ia jepnin vajzën, nuk e jepnin! Edhe ai po të ishte s'do ia jepte vajzën një mejhanexhiu. E ku kish ngjarë; vëllai kapter, babai tregtar i teknikës së bardhë, dhëndri kamerier. Pse, punë që bëhej ishte kjo, hë pasha! Por përsëri një gëzim i pakuptimtë e përshkonte të tërin, dhëpër deti e pandershme!

Do ikim, mendoi. Do ta rrëmbej e do ta çoj në vendlindje, në Hisarllëk, te xhaxhallarët, atje nuk na gjen dot njeri, në Çanakala... Homeri ynë kërkoi fare pakëz vodkë, shkoi e ia solli.

Seç iu kujtua, gotën e ujit që dje e kishte lënë përgjysmë, sot e gjeti të zbrazur. Të *Gjyshit të Etur* duhej të ishin këto marifete, e kishte zemëruar gjysh-in! S'do t'i hynte më asaj pune në hapësirat e tyrbes! A bëheshin këso lloj djallëzish!? Këta dervishët nuk duheshin zemëruar...

Doli nga birraria dhe nga libraria mori letrat. Homeri ynë hipi në autobus për t'u kthyer në shtëpi. S'i kish ngelur as edhe një qindarkë. Ore edhe po s'shkrova punë e madhe, mendoi me vete, sidoqoftë të gjithë shkruajnë; zëre se e shkrova, kush do ta botonte, kush do ta lexonte pale! Po sikur t'i bëj naftën e t'ia mbath që këtej, t'ia shkel për në Çeshme, nga atje në ndërmarrjen *Kopushlar*, drejt e në Sakëz; edhe farefisi ynë është në Rodos tani; a s'do qe më mirë!?

Pse, gjë që bëhet është kjo! Këtë luftë duhej ta shkruante nga fillimi...

I përktheu: **ARBANA REXHEPI**, Shkup
(*Marrë nga libri me tregime "Dashuria, Asgjë...", botuar nga UEGEN*)

¹ *Büyükdada, në përkthim Ishulli i Madh, është një nga ishujt më të mëdhenj në brigjet e Stambollit.*

² **Në turqisht Susuz Dede, sipas gojëdhënave ka qenë një dervish, tyrbja e të cilit ndodhet në rrethinën e Goztepesë në Izmir, në kodrën që mban të njëjtin emër me të tijin.*



NË GJURMËT E TRADITAVE TONA

NGA E KA PREJARDHJEN KOPJA E VETME QË NJIHET NGA LIBRI I BUZUKUT

Dhimitër S. Shuteriqi

Gjon Buzuku dëshmon se për veprën e tij punoi brenda 20 marsit 1554 dhe 5 janarit 1555.

“Meshari” i Buzukut u vu, me sa duket, në indeks nga Inkuizicioni, kështu që libri u zhduk gati krejt dhe sot njihet në një kopje të vetme në Bibliotekën Vatikane. Atë s’e përmend asnjë autor pasardhës përpara Pjetër Bogdanit (1665), Zbulimi që i bëri Nikollë Kazazi (1740) nuk e shpëtoi nga heshtja. U desh që ta rizbulonte Pal Sqiroid, në fillim të shekullit tonë, që të niste e të bëhej mirë i njohur. Gati tre shekuj e gjysëm heshtjeje kaluan mbi librin e parë që dimë të jetë botuar shqip.


Me interes është që të njihet se nga çfarë vendi e ka prejardhjen kopja e vetme e librit të Buzukut. Mbi këtë libër ka disa anëshkrime, ku gjejmë emrat e dy klerikëve që e kanë përdorur atë, një Gjon e një Gjergj, si edhe emrat e tre të tjerëve, të cilët u janë drejtuar dy të parëve me anëshkrimet e tyre, për t’i përshëndetur e për ndonjë porosi: një Mark, një Pjetër e një Nikollë. Në një faqe, ose në kapakun e fundit të librit, lexojmë edhe emrin e një Kola Kuçi dhe, nën këtë emër, kemi fjalën Asanes. Është pikërisht kjo fjalë që na shpuri të kërkojmë prejardhjen e ksomblës së librit të Buzukut nga fshati i sotëm Hasanaj, pak në jugperëndim të Fushë-Krujës. Ky fshat, më 1431 dhe në pjesën e parë të shek. XVII, thuhet Asanes. Një emër mesjetar sllav.

Duke ditur se libri ka bërë pjesë në Bibliotekën e Kolegjit Urban në Romë dhe e ai kolegji u krijua më 1627, kërkuam dokumentet fill përpara dhe pas kësaj date. Në një relacion të njohur të Marin Bicit, të vitit 1610, hasëm në të dhëna me interes të veçantë për fshatrat midis Krujës dhe detit, pranë Asanesit. Kështu, në qershor të atij viti, në Laç ka qenë famulltar një Gjon, ndërsa në Qullës të zonës së Rodonit një Gjergj. Po në këtë zonë, në Muzhëll ka qenë famulltar një Mark (vendas) e në Shporaj një Nikollë, kurse midis këtyre fshatrave dhe Asanesit, në Bëllaj (sot Bilaj), shërbente një Pjetër. Janë pikërisht të pesë emrat që hasim në anëshkrimet e përmendura. Marin Bici na mëson se famulltari i Qullësit ishte, Gjergj Bardhi (i quajtur në dokumente të tjera Maqedoni), i cili shërbente edhe si vikar (zëvendës) i peshkopit të Randësisë, d.m.th. të rrëzave të Krujës e gjer në det. Është pikërisht ai që ka edhe shkrimin më të mirë. Duke qenë më me kulturë se shokët, ai është ngjitur në hierarki. Llagapët e të tjerëve nuk

i dimë, po Nikolla i Shporajt mundet që është Kola Kuçi, të cilin e gjejmë edhe në Asanes.

Që 5 klerikë, emrat e të cilëve i gjejmë bashkë në anëshkrimet mbi librin e Buzukut, t’i gjejmë bashkë edhe në fshatrat pranë Asanesit, në një kohë jo shumë pas botimit të librit, kjo tërheq vëmendjen. Anëshkrimet na bëjnë të mendojmë se Gjoni dhe Gjergji jetonin pranë e pranë, ndërsa tre të tjerët si grup më vete. Gjergji, duke qenë vikar, duhet të ketë qëndruar në Laç, qendër kryesore kishtarë e atyre anëve, pra të ishin shpesh pranë Gjunit. Libri sigurisht ka qenë i Gjunit dhe është përdorur shpesh, me sa duket, nga vikari Gjergj, po herë pas here edhe nga tre të tjerët. Kuptohet se ai libër ishte fort i rrallë, që kur vunë indeks, shumë shpejt mbasi doli, meqë veprimtaria e Inkuizicionit për spastrimin e librave të kishës ka filluar më 1568. Libri ishte në dorë edhe të Kola Kuçit në Asanes.

Ksombla e vetme që njihet sot nga libri i



Buzukut e ka prejardhjen nga fshatrat e rretheve të sotme të Krujës dhe Durrësit, fill në të dy anët e lumit të Ishmit, në zonën fushore dhe kodrinore bregdetare, midis Laçit, Hasanajt e Muzhllit. Që libri e ka prejardhjen nga një zonë bregdetare, këtë e sugjeronte edhe vizatimi i një varke me vela që dikush prej atyre që e kanë pasur nëpër duar ka bërë mbi të. Ky vizatim përcillet me fjalën Aisa. Me këto fjalë do të thotë Ishëm? Që libri vjen nga ato anë, kjo ka rëndësi për historinë e shkrimit të gjuhës sonë në Shqipërinë e Mesme.

Librin e rrallë të Buzukut ka shumë mundësi ta ketë gjetur e konfiskuar Marin Bici. Misioni i këtij ishte që të zbatonte në Shqipëri porositë e Inkuizicionit. Ai duhet ta ketë dërguar kështu librin në Romë, bashkë me relacionin që i bëri Vatikanit aty nga fillimi i vitit 1611 për vizitën e tij tek ne në vitin e kaluar. Kjo nuk na ndihmon që të përcaktojmë mirë datën e anëshkrimeve të librit të Buzukut. Po, me siguri, ato s’janë të gjitha të një viti, janë të disa viteve. Mund të thuhet se i përkasin një periudhe që nga fillimet e Inkuizicionit e gjer në dekadën e parë të shek. XVII, kur s’ka botuar akoma gjë Budi, pra, viteve 1568-1610.



Romani “Koncert në fund të dimrit”

RRËFIMI PËR KINËN, NË FAKT, ËSHTË NARRATIVA PËR KOMUNIZMIN SHQIPTAR

Prof. As. Dr. Ilir Yzeiri

(Vijon nga numri i kaluar)

Pas kësaj veprimi zhvendoset në Tiranë. Në zyrën e Silvës hyn një ditë Ariani, një koleg, dhe asaj i kujtohet një moment dobësie me të në një mbrëmje vallëzimi. Hyn dhe Simon Dersha që kërkon vazhdimisht të flasë në telefon sepse në zyrën e tij aparati është i prishur. E kishte veshur përsëri kostumin blu. Më në fund, Gjergji ka dërguar telegram dhe lajmëron ditën se kur do të kthehet. Futet në veprim edhe një *jo vend* (*non lieu*) tjetër si aeroporti. Është në stilin e Kadaresë që të vendosë ngjarjet në *jo vende*, në kuptimin që ta zhvillojë veprimin në mjedise që nuk identifikohen me shenja etnike të posaçme. Aeroporti është një mjedis që të bën të ndihesh si në Europë, si jashtë vendit si një hapësirë që nuk ka lidhje apo konotacion etnik, siç thotë Marc Augé.

Ndërkohë, në skenë futet edhe një personazh tjetër. Ekrem Fortuzi është një i deklasuar, siç thuhej me terminologjinë e kohës, një ish-borgjez që tani e siguron jetën me përkthime nga gjuha kinezçe. Ai ka shfrytëzuar aftësitë e tij për të mësuar gjuhë të huaja që të sigurojë jetën. I është përshtatur modelit socialist dhe klasor të jetës duke i sfiduar të tjerët me këtë dhunti. Por rendja pas çdo aleati që gjejnë komunistët dhe mësimi i gjuhës së tyre e ka bërë pak qesharak. Dashuria e tij për kinezçen dhe kinezët apo për Maon tregohet këtu deri në kufijtë e karikaturës. Ai dhe grupi i tij shoqëror që kanë si vatrë kryesore Kryekurtët, që ne i njohim nga “Dimri i madh”, paraqiten në roman jo vetëm si të përjashtuar nga jeta sociale, por edhe pak të shkatërruar psikologjikisht, madje me dramë të thellë siç ishte fati i Llukë Alarupit, një ish-pronar i fabrikës së sapunit që tani ishte transformuar në një agjitpropas komunist dhe ndiqte realizimin e planit të fabrikës duke llogaritur gjithnjë edhe përqindjen e tij të fitimit. Lart, në katin e dytë, është Marku me të fejuarën e tij duke mësuar frëngjisht. “*Il fait froid*” i pëlqen të pëshpërisë e fejuara e tij që i lutet herë pas here t’i tregojë historinë me ish të fejuarën e Besnikut, Zanën. Këtë pleksje gati perëndimore të fateve të disa personazheve e kishte vënë re edhe censura kur shkruante:

“Personazhet pozitive në roman jo vetëm që janë të kufizuar në numër, por; për hir të “objektivizmit”, të gjithë janë me mangësi të theksuara. Gati të gjithë kanë drama e ndarje në dashuri, duke përfshirë edhe Lindën që është më e reja. Disa janë martuar dy herë. Përse personazhet pozitivë duhet të kenë patjetër “dramën” e tyre. Vetëm për hir të teorisë sipas së cilës nuk ka heronj të përsosur? Midis pesonazheve pozitivë e armiqve në roman kemi një galeri të tërë personazhesh e tipash të lëkundshëm, madje negativë: S. Dersha, gruaja e tij, i vëllai, gruaja e vëllait. Të tillë janë edhe ndërlidhësi, shefi i kuadrit, i zbulimit etj. Përse duhen në një roman që paraqet luftën dhe qëndresën tonë, kaq shumë elementë të lëkundshëm, pa karakter, pa personalitet?”¹

Ky pasazh që citova nga teksti i një prej punonjësve të aparatit të KQPPSH-së për kulturën, që në fakt ishte censura politike, zbërthen në mënyrë brilante edhe vlerën e romanit. Siç e përmenda edhe më sipër, kjo vepër është ndërtuar e gjitha me logjikën e transferimit ligjërimit; pra, përshkrimi i diktaturës kineze, i paranojave dhe krimeve të liderit kinez, i masakrës që bëri mbi mendjet e kinezëve revolucionari i tyre kulturor me mjetet, topikën dhe mënyrën e të menduarit shqiptar. Kadareja kishte magjinë e nuhatjes si shkrimtar gjenial që kjo frymë e tharjes së jetës, e shkatërrimit të letërsisë, e shpëlarjes së trurit kishte mbërritur edhe në Shqipëri dhe nuk nguronte që në krijimtarinë e tij të vizatonte atë oazë europeist që censorët politikë të indoktrinuar edhe me revolucionin kulturor kinez, jo vetëm që nuk e pranonin, por e quanin edhe herezi. Kulmin e këtij vështrimi, Kadareja e arrin me personazhin C.V. kritikun letrar i cili, i ngazëllyer nga afshi i revolucionit kulturor kinez, kishte propozuar që veprat në Shqipëri të shkruheshin pa autor dhe, mundësisht, çdo rreth të paraqitej me një gjini të vetën: psh: romani i shkrimtarëve të Poliçanit apo poezitë e poetëve skraparlinj. Janë të bukura në roman gjetjet e emrave të ekspozitave kineze që hapen në Tiranë si grupi skulptural i veprës “Oborri i vjeljes së taksave” (f. 187). Dhe pikërisht këtu, Kadareja përdor termin “kinezëri”:

“qeflinjtë e kinezërive, megjithëse të rrallë, u bënë të tillë jo sepse deshën, por sepse gjetën në kinezëritë një mbështetje për mungesat e tyre, për paafësinë, mungesën e talentit, smirën,

kompleksin e inferioritetit, varfërinë shpirtërore e gjer te ligësia e thjeshtë apo dreqi e di çfarë.” (f.189)

Pasi u nda nga Skënder Bermema, Silva ndjeu se kishte në fytyrë ende një mbeturinë buzëqeshjeje, thotë autori, po këtu.

Në roman ka edhe detaje që të bëjnë të kujtosh se si ka ndryshuar kultura e komunikimit në kohë. Më kujtohet se, kur lexoja kujtimet e Mustafa Greblleshit², diku, ai kujton një mikun e tij që me kohë u dha pas pijes dhe, kur sjell ndërmend një bar në Pazarin e Vjetër, kujton se atje miku i tij dhe të dehurit e tjerë, kur pinin, recitonin Omer Khajamin deri në mesnatë. Në romanin e Kadaresë, Silva sheh një ditë në kafe “Riviera” të shoqin me një femër dhe i hyn krimbi i xhelozisë, pastaj kujtohet se i shoqi kohët e fundit kishte filluar të lexonte poezi dashurie. Të duket sikur kanë kaluar qindra vjet.

Rrëfimi ecën shpejt, Sajmiri arrestohet, Gjergji i tregon Silvës për shkretëtirën njerëzore në Kinë dhe i thotë se kisha nevojë t’ia tregoja dikujt atë që përjetova atje, sepse, nëse ti i flisje një fjalë shoqëruesit, ai ta kthente me një citat të Maos: “në qoftë se ti i thoshe se fryn erë, shoqëruesi të përgjigjej se era e Lindjes sundonte mbi të Perëndimit. po t’i thoshe shiko ç’mjegull, të përgjigjej se Kryetari Mao ka thënë mjegulla u pëlqen imperialistëve e revizionistëve”. (f. 216) Pastaj parrulla të thata ngado. Në vend të të thoshin “Mirëmëngjes” të thoshin “Popujt tanë, megjithëse janë larg, janë vëllezër”. (Po aty)

Kështu mbyllet edhe kapitulli i gjashtë që, veç arrestimit të Sajmiri, ekspozitës kineze të poqeve dhe vizitës aty të Ekrem Fortuzit e Silvës, ka edhe një vizitë te varri i Anës, motrës së Silvës dhe ish-gruas së Besnikut.

Kapitulli më pas hapet me vizatimin metaforik të çastit që ka rutina e jetës. Atë vetëm Kadareja mund ta vizatojë: *Silva u zgjua me mbeturina ëndërrash në sy*. Pastaj autori vë në lëvizje njerëzit e afërm pas arrestimit të vëllait të Silvës, tankistit Sajmir. Në zyrën e Silvës vjen Besnik Struga dhe Linda, e joshur nga hija e tij, nuk e kupton as vetë se si ndihet. Në shtëpi vjen edhe një teze e Silvës që është martuar me një të deklasuar si për të thënë se tani jemi njësoj dhe në fund, një mbrëmje në Ministrinë e Jashtme.

Kapitulli i tetë i kushtohet një maoisti europian. Huan Maria Kramsit dhe ngjarjet zhvillohen sa në Paris, ku Kramsi shkon, sa në një ambasadë lindore, përfshirë edhe atë shqiptare, në tjetrën. Kadareja është treguar i pamëshirshëm me këtë personazh dhe ironia e tallja me të, mesa duket, ka

2 Mustafa Greblleshi, KUJTIME 1939-44, Botime ÇABEJ, Tiranë 2017.

brenda gjithë zemërimin e autorit për mendjelehtësinë e disa europianëve që jo vetëm nuk e denonconin komunizmin në botë, por ishin bërë edhe viktime të ideve të tij. Karikatura e tij si personazh dëfthetet mëse njëherë në roman për të përfunduar në frazën lapidare:

“Gjithë qënia e tij jetonte tani me kongreset e partive të shumta, grupeve, fraksioneve të reja të lindura pas thërmimit të partive marksiste-leniniste, me plenumet e programet e shpallura, ndryshimet në linjat e përgjithshme, dy vija apo tri vijat në gjirin e tyre, pikëpamjet reformiste, tendencat sindikaliste, rrugët e kalimit në socializëm, pikëpamjet për dhunën, për mjetet paqësore, për terrorin, anarkosindikalizmin, kompromisin historik, botën e tretë. – A s’ke mërzi nga të gjitha këto? – i kishte thënë njëherë një shok. Huan Maria Kramsi ishte zemëruar si rrallëherë në jetën e tij” (f.275).

Pastaj autori tregon se ata kishin ndenjur deri në mëngjes duke polemizuar e zënë. Kramsi e kishte akuzuar shokun e tij për nja shtatë devijacione dhe, diku ndaj të gdhirë, shoku i vet i kishte thënë: “*ti je djalli vetë, ti je anti jeta*” (po aty). Pastaj tallja me të arrin një pikë kulmore kur Kadare përshkruan vizitën e tij në Shqipëri dhe habinë e tij që këtu kishte ende shkrimtarë, romane, njerëz që vrisnin veten për dashurinë dhe nuk kishte ndodhur ende procesi shndërrues “*çshkrimtarizues*”, siç thotë Kadareja. (f.277). Ka dhe një pasazh në këtë kapitull që është një lloj diversioni i hapur që Kadareja bën po të përmendim një term të Arshi Pipës³ kur ai analizon veprat e Kadaresë e sidomos “Kronikë në gur” e “Dimrin e madh”. Kramsi, thotë autori, kishte pritur më shumë prej shqiptarëve, sidomos pas ndalimit të fesë dhe mbylljes së kishave.

“Atëherë qe mahnitur me ta. Shqipëria kishte kapërcyer një prag që s’kishte guxuar ta kapërcente askush. Ëndrra që Nicja kishte profetizuar në “Antikrishtin” e tij po realizohej. Net të tëra Kramsi nuk përfytyronte veç buldozerët që rrëzonin kishat e katedralet, kumbanoret e thyera, kryqet që binin...”(f. 278)

Dhe pak më tej, Kadareja gati sa nuk denoncon hapur jo vetëm këtë krim makabër mbi traditën historike shqiptare, por vë në psikikën e të menduarit të këtij maoisti që ishte aq në modë nga udhëheqja komuniste shqiptare, edhe një pandehmë tjetër:

“Por zhdukja e fesë nuk do ta gazmonte aq shumë Kramsin, në qoftë se nuk do të parathoshte një tjetër proces. Ai ishte i bindur se kishat do të tërhiqnin pas vetes në varr një kulturë të tërë të vjetër: shekuj letërsie të shkruar nga shkrimtarë murgj, ikonat mesjetare, piktorë, poetë, filozofë, vetë Gjergj Kastriotin dhe legjendën e tij shkatërrimtare”. (f.279)

Pra, gjithë duke përdorur teknikën e transferimit ligjërimitor dhe meqenëse romani ka karakter polifonik, autori, herë drejtpërdrejt e herë në mënyrë të kamufluar, jo vetëm që ironizon lëvizjet marksiste-leniniste në botë, por gjen rastin të çmontojë edhe konstruksionet antikombëtare që ishin ndërtuar në Shqipëri atëherë kur komunistët shqiptarë iu turrën shkatërrimit të kulteve dhe objekteve fetare në emër të ndalimit të fesë. Dhe, për ta shkatërruar tërësisht si personazh, ai përdor ironinë therëse. Kramsi, që ishte joshur nga rafshimi i jetës mondane europiane, kishte përgatitur një studim me titullin: “*Darka opozita e fundit kundër botës së re*.” (f. 280). Nuk i shpëton as Kosova mendimit të Kramsit që e quan një gjë nacionalromantike, të kapërcyer. Kramsi paraqitet jo vetëm si një fantazmë e antijetës, por edhe mendërisht i mbyllur. Kadareja nuk kursen asgjë në vizatimin e tij. Ai, thotë autori, ishte mahnitur me Mao Ce Dunin, sidomos me thënien e tij se “*komunizmi mund të vonohet në botë dhjetë mijë vjet*”. Nuk është vështirë të kuptohet se ironia dhe cinizmi në këtë rast, nuk ishte vetëm ndaj Kramsit, por edhe ndaj gjithë atyre që e kishin komunizmin si model. Ironia me teoritë e botës së tretë, me primitivizmin, apo thënie si kjo që për të kuptuar shprehjen “*pikëllim vjeshte*” duhet të kalonin një mijë vjet, apo vargje si “*Kamboxhia fillon te ti*”, Kadareja i përdor për të demistifikuar një lëvizje të tërë që jo vetëm kishte shënuar krime makabre si në Kamboxhia, por kishte tharë gati gjysmën e globit me idetë absurde të komunizmit kinez e jo vetëm.

Kapitulli që pason, i nënti, rrëfen ngasjen e Simon Dershës që do të takojë ministrin për një hall personal, vajtja deri te vila, pastaj përmendja për fjalët që fliteshin për të se po binte nga vakti. Më te vendin qendror e zë ministri D të cilin Kadare e paraqet si një lodër në duar të sovjetikëve e kinezëve. Kujton vizitën e tij në Kinë dhe rekrutimin e tërthortë nga kinezët, gjithë sipas narrativës zyrtare të kohës, për të rrethuar një komitet partie. Ftesa në një dramë ku sekretarin e partisë e tërheqin zvarrë në skenë. Drama është vendi ku mund të marrësh vesh poltikën e Kinës, i kishte thënë dikush. Ti që lexon romanin, kujtohesh për një frazë nga Hamleti “drama është gracka ku shpirti i mbretit kapet si laraska”. Pastaj veprimi zhvendoset në Kinë. Skënder Bermema së bashku me kritikun C.V. do të vizitojnë Kinën. Ftesa është e çuditshme: me rastin e Ditës së Zogjve.

3 Arshi Pipa, Subversion drejt konformizmit fenomeni Kadare, Shtëpia botuese Phoenix, Tiranë 1999



Jemi në Pekin, në një dhomë hoteli dhe, nëse në një vend më sipër Silva ishte zgjuar me mbeturina ëndrrash në sy, këtu, Skënder Bermema sapo hap sytë, shikon jashtë dhe te perdet ishte përsëri e diela. Ky stil animistik e metaforik bashkë është tipar i narrativës së Kadaresë.

Në këtë kapitull autori ndërthur disa linja subjekti. Gjithnjë e më shumë përsëritet ankthi i S. Bermemës për vdekjen e një romani, të atij që nuk e shkruan dot. Pastaj dikur nxjerr fletët dhe sheh sinopset. Ndër to, ai për Komisionin e krijimit të njeriut të ri kinez, Lej Fenit, është pa dyshim më i bukur. Komisioni që do ta krijonte atë, netët pa gjumë dhe ideja për të lindur një njeri sipas maocedunidesë janë ushqim për fantazinë e Kadaresë që kalon çdo imagjinatë të mundshme. Pra, përfytyroni komisione pafund në Kinë, një maternitet i tërë që punonte për të lindur njeriun e ri. Aluzioni është i qartë. Si duhet të ishte ai? Mesatar, pra, një kompromis, i thjeshtë, një vidhë e mendimit të Mao Ce Dunit, asnjë gjë origjinale, i rëndomtë, asnjë lidhje dashurore, me origjinë fshatare, ushtar, të huaja për të duhet të ishin krenaria, individualizmi dhe mireqënia, mblidhte kuti të vjetra, pastë dhëmbësh, për t'i shitur pastaj dhe për t'ia dorëzuar paratë shtetit. Më pas, jetën e tij, përvojën, duhet ta linte të shkruar. Po në ç'formë? Në formë denoncimesh në komitet të partisë a në hetuesi dhe pastaj vdekja, si do të ishte ajo, aksidentale apo natyrale. Nëse do të zgjidhnin vdekje nga zemra, kjo i ngjante vdekjes së intelektualëve borgjezë, nga heqja e barkut jo se lidhej keq me fshatin dhe, më në fund, u gjet: e shtyp treni dhe kjo ilustron edhe teorinë e Maos që fshati rrethon qytetin sepse heroï do të vdiste duke u përjekur të shpëtonte një kalë (fshati) që kalonte në shina dhe e shtyp treni (qyteti). Këtë ndjenjë humori dhe satire vetëm Kadareja mund ta krijojë. Në kapitullin në vazhdim janë të famshmet cjetinçi, përgjueset që shpërndahen në Kinë. Edhe këtu ka faqe të mrekullueshme që vizatojnë një nga kapitujt më të errët të diktaturave, përgjimin e shtetasve dhe klimën e terrorit.

Kapitulli që pason, ka në qendër koncertin në Pekin. Skënder Bermema dhe kritiku C.V. do të marrin pjesë në të, por gjithë vëmendja është te lozha, si do të shfaqet Çu En Lai. Pastaj simbolika e koncertit, vajza valltare në reshtin e dytë dhe copa prej mëndafshi lejla që ajo do të vërtisë në ajër. Pastaj vjen vdekja e Maos. Këtë lajm S. Bermema, që nuk kishte gjumë, e mëson nga dezurni i hotelit, të cilit Bermema kishte frikë t'i fliste për fjetjen apo gjumin se, nëse i thoshte që nuk po fle, ai i përgjigjej: kryetari Mao ka thënë se ujët fle, po imperializmi nuk fle. Nuk është vështirë të kuptohet këtu tallja edhe me parullat politike tonat, nëse mbajmë në vështrim transferimin e ligjërimit që përdor si mjet të narrativës Kadareja. Mirëpo *“Chairman is daying”* i thotë me lot në sy dezhuri kinez. Mao vdiq.

Efektin e saj, autori e jep menjëherë në Tiranë, por e përqendron vëmendjen te pritja që i bëjnë asaj ata që në atë kohë quheshin shtresa e deklasuar. Ekrem Fortuzi e ndien rëndë dhe gjithë shtresa e tyre po ashtu. Përsëri Gjergji niset në Kinë dhe kapitulli që pason, tregon arrestimin e gruas së Maos, Sajmiri ka dalë nga burgu dhe ministri e thërret për gjoja pajtim. Ndërkaq, Skënder Bermema shfleton sinopset e tij dhe këtë radhe vëren se midis Makbethit, darkës dhe vdekjes së Lin Biaos ngjashmëria është fatale. Ndërkaq, rrëfimi rrjedh shpejt. Narratori kthehet në Tiranë dhe në gjithë vendin kanë filluar të ndihen pasojat e ndërprerjes së ndihmave nga Kina. Silva dhe shefi i saj shkojnë me shërbim në Metalurgjik. Simon Dersha i zbraz ankthin që e mundon Lindës dhe i tregon me ngashërim për darkën e gabuar. Kinezët largohen përfundimisht dhe studentët shqiptarë kthehen nga Kina.

Kapituilli tjetër është shkruar me stilin e Kafkës. Nëse si ton i përgjithshëm i rrëfimit është gjendja e kohës pezull, pra, as shi, as borë, por pritje, tani rrëfimi vendoset në zonën e errët të frikës dhe fjala që e organizon atë nga pikëpamja e semantikës së tekstit, është: *“Thellohu!”* Kanë filluar mbledhjet e gjata me net pa gjumë për grupet armiqësore dhe ata që duhet të rrëfejnë krimet, asnjëherë nuk i bindin ata që i dëgjojnë, sepse mbi ta rri si një thikë në qafë fjala: *thellohu*. Vendi zien nga autokritika dhe shpjegime që nuk bindin ata që kanë në dorë fatin e atyre që çmohen si fajtorë.

“Mbledhjet vazhdonin gjer natën vonë sidomos në dikasteret qëndrore. Edhe më vonë, pas mesnate e disa herë gjer ndaj të gdhirë rrinin ata që duhej të bënin autokritikë. Flinin studiuesit e akademikët, flinin njëri pas tjetrit shkrimtarët, madje edhe ata që merreshin me gjinitë e gjata, flinin asistentët që përgatisnin leksionet e së nesërmes, përkthyesit nga greqishtja e vjetër, hartuesit e fjalorëve, grafomanët, shkruesit e letrave anonime e të padive të divorcimit, flinin më në fund edhe ata që shkruanin letra dashurie e që zakonisht u duhej të rrinin jo më pak se dy orë zgjuar pas shkrimit të frazës së fundit, me një fjalë, flinin të gjithë ata që puna, ndjenjat apo rasti i lidhnin me lapsin dhe letrën, me përjashtim të bërësve të autokritikës”. (f. 622)

Ishte kohë plenumesh dhe fjalët që dëgjoheshin më



shumë, ishin “puç” e “puçistë” thotë autori sikur të jetë duke treguar për një vend të juntës amerikanolatinë dhe jo për Shqipërinë. Njerëzit janë pak si në jerm dhe teto Hasija përzien kohët ashtu si në një rrëfim psikanalitik. Sipas saj, radioja një ditë më parë shante ata që ajo i quante turq. Kjo zhvendosje e kohës dhe fshirja e kufirit mes ëndrrës dhe gjalljes është karakteristikë e rrëfimit edhe të Kadaresë në ndonjë rast. Vulën gjithë kësaj zëdhalljeje ia vë Rrema, fshesaxhiu i “Dimrit” që ka ardhur të shohë kolegët e rrugës që qeshnin me kinezët, por Rrema u thoshte se nuk hap gojën se i hëngra dy javë burg për Hroshovin. Dhe të gjithë kujtojnë me ngazëllim, thotë autori, fjalën e kryetarit të bashkimeve profesionale me rastin e daljes në pension të Rremës. *Ti fshive për tridhjetë e pesë vjet rrugët ku kaloj njeriu i ri*. Shpjegimi këtu është i tepërt. Ironia e Kadaresë nuk kursen më asgjë. Ndërkaq, edhe përgjuesit e Polit të Veriut përpiqen të deshifrojnë atë që po ndodh në Kinë e më gjerë.

Në qoftë se romani nis me një festë, me ditëlindjen e Brikenës, ai mbyllet me një vdekje. Në furrnaltën e Metalurgjikut ka humbur jetën Maksi, kushëriri i Bermemës dhe është plagosur Beni, vëllai i Besnik Strugës. Ndërsa Viktor Hila ka humbur sytë. Linda është lidhur me Besnik Strugën dhe në mortin e kushëririt të tij shkon bashkë me Silvën. Kur kthehet në shtëpi, Silva kujtohet të heqë plastamasën nga limoni. Ai kishte lëshuar disa kokrra të vogla jeshile. Kështu mbyllet romani.


Përfundime

- Romani “Koncert në fund të dimrit” nuk është një roman për qëndresën e popullit shqiptar ndaj tradhtisë kineze, sic jemi mësuar ta dëgjojmë nga tekstet zyrtare të kritikës socrealiste. Është një rrëfim epik me personazhe historikë dhe me të trilluar që rreh të paraqesë një nga periudhat më të errëta të historisë botërore që është diktatura e komunistëve kinezë dhe arkitektit të tyre, Mao Ce Dun. Kjo pikënisje i ka shërbyer atij që me anë të të transferimit të ligjërimit të bëjë anatominë e shkatërrimit shpirtëror të njerëzve në të gjitha diktaturat. Ngjarjet në Kinë përdoren vetëm si model për të ilustruar makabritetin e krimit të diktaturave komuniste. Përballë revolucionit kulturor që rrafshoi vlerat më të qenësishme të kulturës kineze, Kadare vizaton oazet e mbetura europeiste në Shqipëri, por parashikon edhe këtu krimet që do të ndodhnin më pas sipas logjikës diktatoriale.
- Jo vetëm stili është i lëmuar dhe jo vetëm tonaliteti i rrëfimit është zgjedhur me kujdes, por edhe vetë gjuha është punuar gati si me limë. Edhe këtu tërheqin vëmendjen fjalëformimet e tij me vlerë stilistike si psh: gratë shqiptare nën ndikimin e revolucionit kinez kishte rrezik të “çgrarizoheshin”, nëse zakonisht mbajmë ditar, në roman Bermemës i takon të shkruajë natën dhe të

- mbajë një *“natar”*. Dikush ka biografi të mirë dhe sytë e bukur dhe ajo është *“biografibukura”*. Ndërsa në roman ka dhe personazhe që ngazëllehen nga jeta socialiste me mitingje dhe ata vuajnë nga *“ngazëllimi mitingo-presidiumor”*. Duke luajtur me fjalën tri botë ai e quan *“trifshatarësi”* një personazh në roman. Ata që janë përfshirë nga ethet e autokritikës, janë *“autokritistët”*, lindja e një gjuhe të re pas revolucionit kulturor, atij i duket si një *“zhgjuhë”* etj. Nganjëherë, portretizimi i personazheve arrin në paraqitje absurde dhe ana qesharake e tyre zmadhohet aq shumë, sa ironia dhe satira mpleksen keq. Li Pan, një përgjues profesionist në Kinë, kishte nxjerrë sytë në mënyrë që t'i rritej dëgjimi.
- Karakteristikë tjetër, sidomos e stilit të tij narrativ, është se në gojën e kinezëve vihen fraza klishe dhe stereotipe të ligjërimit të ngurtë totalitar shqiptar. Rrëfimi për Kinën, në fakt, është narrativa për komunizmin shqiptar. Autori nuk kursen asnjë, as talljen me qethjen e të huajve në Rinas.
- Është me shumë interes të thuhet një prirje tjetër e narrativës së Kadaresë që ka të bëjë me hapësirën e veprimit dhe me kohën. Hapësirat në disa raste janë më së shumti *jo vende*: aeroporti, hotelet, baret, zyrat e një dikasteri, avioni. Ndërsa koha e veprimit, në shumë raste, është një festë familjare dhe sidomos darka familjare, mbremja, rituali i kafesë në shtëpi apo salla e një koncerti, apo eskpoziteje dhe bulevardi. Gjithë kjo hapësirë i lejon autorit që të ndërtojë oazën europeiste të Shqipërisë. Duke e theksuar veprimin në këtë ambient, ai, në fakt, projekton një Shqipëri tjetër, një utopi të ndryshme.
- Ky roman, së bashku me “Dimrin e vetmisë së madhe” apo “Dimrin e madh” do të ruhen në kujtesën tonë si dy nga kryeveprat që regjistruan me mjeshtëri jetën shqiptare në diktaturë në dy nga momentet më të papërsëritshme të historisë së komunizmit botëror. Ne kishim fatin tragjik se ishim autorë dhe personazhe të asaj epoke.

Në vend të mbylljes

Siç e thashë në fillim të këtij shkrimi, sot bota është përfshirë në epokën e globalizmit dhe nuk ka më kufij ideologjikë që të vështirësojnë komunikimin. Megjithatë, keqkuptimet vazhdojnë. Ngjarja e fundit me koronavirusin, misteri që e rrethon shkakun dhe përhapjen e tij lidhen me një vend që megjithëse formalisht nuk është një vend tipik komunsit, ruan ende tiparet e shtetit njëpartiak dhe komunikimi i tyre nuk mbështetet te fjala e lirë dhe mendimi i lirë. Për këtë arsye, misteri, keqkuptimet dhe mungesa e së vërtetës janë plagë të trashëguara nga ajo traditë që atje lidhet me themeluesin e Kinës së re, Mao Ce Dun, portretin e të cilit ata e ruajnë me fanatizëm.



DHOMA NË TË CILËN ZHDUKEN HAPAT

tregim nga
Milorad Paviq

(Ngjarja zhvillohet në shtëpinë Nr. 2, në rrugën
“Svetozar Radiq”.)

Në fillim, hajde të prezantohemi. Mua më quajnë Ingerina. Gjithmonë kam shfaqur ndjenja të veçanta simpatie për Lenën, heroinën e këtij tregimi, ndonëse ajo u përket atyre njerëzve që gjatë ndarjes iu pëlqen të thonë “mirupafshim” të paktën dy herë. Megjithatë, ajo kishte një shpirt të dëgjueshëm, në të cilin jehona të përgjigjeve gjithmonë dy herë, brenda një pauze të gjatë e të qetë midis dy të tillave. Dhe përveç kësaj, ne të dyja jetonim në të njëjtin tregim.

- Ekziston një moshë e tillë kur në pëllëmbët e duarve fillojnë të shfaqen qime. Në fillim te djemtë e më pas te vajzat. Të tilla qime nuk duken, mirëpo të gjithë e dinë faktin se ato ekzistojnë, si dhe arsyen përse dalin. Ata që nuk kanë akoma, pasi e marrin vesh këtë risi, vështrojnë duart e tyre dhe kështu e nxjerrin sekretin e vet...

Kështu mendonte Lena, e cila duke qeshur ngjiste shkallët e shtëpisë Nr. 2, në rrugën “Svetozar Radiq”. Hyrja ndodhej nga oborri, atje ku në murin prej guri ishte ndërtuar një si oxhak i mrekullueshëm, prej blloqesh shtufi të gdhendur. Pranë tij ngrihej përpjetë tuja shtatlartë, e ngjashme me qiparisin. Këtu, në katin e parë, Lena kishte zënë me qira një apartament, më saktë një dhomë mjaft të madhe, që mbushej me erërat e lumit Sava. Raftet me librat e një të vdekuri zinin gjithë faqen e murit, deri në tavan, kurse në qoshe ndodhej krevati i dikujt, me jastëkë të shumtë dhe dyshek të fortë si dërrasë. Librat ishin të mbajtur mirë, si çdo i tillë kur askush nuk e lexon. Në njërin nga raftet, tamam sipër librave, ishte mbërthyer një pasqyrë me një vrimë

në qoshe. E gjithë ndërtesa binte erë lëkure dhe duhani të tymosur dikur me llullë. Kohë më parë ajo kishte qenë e një burri. Tashmë përmes njëres dritare depëronte era e specave, kurse nga tjetra futej duhma e qumështit të djegur.

Pasi u fut në apartament, Lena nxori nga njëri xhep macen dhe e lëshoi mbi dysheme, kurse nga tjetri furçën e dhëmbëve. Nga çanta e shpinës hoqi kompjuterin dhe e vuri mbi lavaman, i cili gjithashtu nuk kishte ujë, kurse në dritare, në vend të perdeve, vari dy fustanet e saj verorë. Që nga ajo ditë, çdo të shtunë shkonte në kopshtin zoologjik, i cili nuk ishte larg shtëpisë, dhe regjistronte zëra shpendësh. Ajo e fillonte me piskun (shpend ujërash) dhe e vazhdonte me listën të përbërë nga emra shpendësh që përmenden në veprat e Shekspirit. Lena dëshironte të regjistronte këngën e tyre të përbashkët dhe pastaj të përpiqej të zbërthente diçka prej saj. Kurse të enjteve i ndante flokët në mes dhe mbërthente në ta fillin me rruaza të vogla të bardha prej qelqi, të cilat i vareshin mbi ballë, deri te rrëza e hundës. Pastaj në këtë dhomë na mblidhte ne, bashkëstudentët e fakultetit, ku edhe vetë studionte, dhe duke ngritur të gjithë volumin vinte muzikën nga filmi “Parku jurasik”. Këto grumbullime ajo i organizonte çdo të enjte, nga ora njëmbëdhjetë e mbrëmjes e deri vonë.

Më kujtohet një grumbullim i tillë, i pari, kur Pavël Bornemisiti nga pakujdesia i shpëtoi se Lena mund të na vinte të dëgjonim regjistrimin e zërave të shpendëve ose të na rrëfente se çfarë i ishte shfaqur në ëndërr një natë më parë...

Si zakonisht, Lena nuk ia lejoi vetes që t'i luteshin gjatë.

- Mua m'ushfaq në ëndërr një errësirë, a e kuptoni!

Tamam sikur po ecja përmes varrezave dhe njëfarë drite e turbullt, më e rëndë se ajri, qëndronte mbi kryqet, kurse unë sikur po kërkoja një varr, pa ditur se cilin, por dija vetëm se si e kishte pamjen. Po çaja me vështirësi, këmbët më ngatërroheshin nëpër bar, por, megjithatë, disi po lëvizja dhe tashmë e dallova: në muzg zbardhte ajo që unë kërkoja, një pllakë e madhe varri prej mermeri. Në të nuk kishte emër, por ndodhej fotografia së cilës që larg i dukej mirë forma ovale e kornizës, me një shirit ngjyrë ari, siç janë zakonisht në përmendore. I afrohem që të vështroja fytyrën dhe thjesht ngriva e tëra. Në vend të fotografisë, në kornizën e pllakës së varrit, ishte vendosur një pasqyrë e vogël. Një pasqyrë e çuditshme prej kristali. E di, se po të vështrosh në të, sheh errësirë, një errësirë të plotë, e kuptoni, por diçka sikur më nxiste apo më tërhiqte të vështroja në pasqyrë, a e kuptoni, thjesht po më tërhiqte. Përveç kësaj, lartësia e përmendores ishte tamam sa trupi i njeriut, kështu që mund të vështrohesha lehtë dhe unë, pa mundur të përmbahesha, hodha sytë në të. Por që andej nuk më vështronte aspak fytyra ime, por e dikujt tjetër.

Përveç kësaj, sytë ishin të një burri. Atëherë vura buzën në gaz, për të kontrolluar se kush ishte me gjithë mend atje, në pasqyrë, unë apo jo. Por fizionomia mjekroshe gjithashtu po më buzëqeshte dhe gjatë kësaj kohe në gojën e këtij tipi shkëlqente një dhëmb i artë... Thjesht ishte një errësirë e plotë, a e kupton...

Unë nuk i pëlqej historitë të tilla të Lenës dhe për të futur gjallëri në darkën tonë, thashë:

- Ju nuk e besoni, por Igori të premten e kaluar puthte në mënyrë fenomenale dhe ajo kishte shijen e nxehtë të manit të bardhë... Si edhe më parë, Prokopi këtë gjë e arrin pasi tymos puro nga Havana. Ida në mënyrë të paharrueshme të puthte pllaj e pllaj, ndërkohë që ishte shtatzënë, ndërsa tani nuk kemi asgjë të veçantë.

- Po Liza?

- Ajo ia arrin si s'ka më mirë, kur në mënyrë të alternuar puthet sa me një burrë dhe sa me një grua. Për sa më përket mua, më tepër më pëlqen ta bëj këtë në sy të shoqërisë, kur jemi të gjithë bashkë, ja si sot, në këtë mbrëmje...

- Po kush i ka puthjet më të ëmbla?

- Pavël Bornemisiti. Por, ç'është e vërteta, ai preferon që ta bëjë këtë kur është vetëm. Ndoshta për faktin që di frëngjisht. Ata që dinë frëngjisht puthin plotësisht ndryshe nga të tjerët, megjithatë nuk e di saktësisht. Me rusët, për shembull, nuk jam puthur, por ma merr mendja se nuk puthin njëloj si ata që të thonë “mirëmbërma” në italisht.

- Po unë? - më pyeti Lena.

- Ti Lena, në përgjithësi nuk di të puthësh; pështymën e ke të kripur, - ia preva unë, - dhe asnjëherë s'e ke parë filmin “Burri i tretë”. Kudo dhe vazhdimisht flet vetëm për ëndrrat që sheh. Edhe këto darkat e tua janë tmerrësisht të mërzitshme. Gjithmonë po të njëjtat fytyra dhe asnjë të re.

- Po cilin propozon ti të ftojme?

- Hajde të ftojme ndonjë lexues.

- Për çfarë lexuesi e ke fjalën?

- Po, të paktën lexuesin e këtij tregimi. Përse ai të mos vijë? Do ta shohësh se si do të na i mbërthejë sytë. Ai na dëgjon me heshtjen më të thellë. Ja, sikur të merrnim vesh se si puth ai... dhe nëse di t'i japë biçikletës me prapanicën përpara, të ulur mbi timon.

- Po si ta sjellim këtu?

- Pikërisht kjo nuk është e vështirë, - u përfshi në bisedë Pavël Bornemisiti, - le ta gjejë e ta ftojë atë Jaucini. Si botues i ardhshëm ai di të komunikojë me vëllezërit lexues. E kujt më shumë se një botuesi i përket të kërkojë lexuesin?

- Mirë, por vetëm kur ta sjellë, mos e ngacmoni menjëherë me pyetje të tipit: si të quajnë; mos e

ke mbërthyer këmbën e djathtë të pantallonave te këpuca e majtë, ose kundërta. Kjo është e pahijshme. Lexuesit janë shumë të turpshëm. Brenda një minute ata do të zhdukeshin. Mund t'i luteni që të nënshkruajë ndonjë libër, por pa i bërë asnjë lloj pyetjeje.

- Mirë, por do të sjellësh lexues apo lexuese?
- Kë të gjej.
- Po pse, mos janë kafshë të rralla?
- Varet nga tregimi. Nganjëherë, madje, ata janë kaq shumë, saqë nuk i mban brenda një dhomë e tillë si kjo.

- Vetëm shiko që në vend të lexuesit të mos na rastisë ndonjë kalama me F.L.U (me grip).

- Dhe një kontroll i tillë nuk është i vështirë. Kur unë ta sjell, Ingerina do të qëndrojë përballë kësaj pasqyre me vrimë dhe me vëmendje do të hetojë nëse lexuesi reflektohet në pasqyrë. Në rast se ajo nuk sheh atje fytyrën e tij, do të thotë se ai është i vërtetë, sepse lexuesi nuk duhet parë në pasqyra prej letre të librave, të tilla si tonat.

Sigurisht, asnjë nuk e besoi se Jaucini do ta mbante premtimin, mirëpo të enjten tjetër, në dhomë u fut me vrull Pavël Bornemisi. Ai hoqi nga goja llullën e vet të fortë dhe shpërtheu:

- Ai erdhi!
- Kush erdhi?
- Lexuesi!
- Ç'pamje ka?
- Me xhakavento lëkure, mëngët i shkëlqejnë si çizme.

- Ku e gjetet?
- Ai erdhi vetë, nëpërmjet oxhakut doli në kopsht. Por nuk pranon të futet. Merreni me mend, këtë dhomë ai e quan dhomë ku zhduken hapat.

- Çfarë ka parasysh?
- Pyeteni vetë. Ai thotë se tashmë ka qenë në të, se ka bërë disa hapa dhe pastaj i ka humbur ato.
- Gënjën!
- Ndoshta, megjithëse në atë kohë, ndër të tjera, mundet, jo... Natyrisht që po gënjëj.

Këto fjalë të Pavlit shkaktuan shpërthim të qeshurash. Dhe për habinë e të gjithëve, brenda u fut Jaucini, të cilin e ndiqte me të vërtetë një i ftuar. Ai ishte një tip i çuditshëm, plotësisht i panjohur dhe pakëz më i ri se ne. Ndërkohë që po njihej me radhë me të pranishmit, Pavli më shqiptoi:

- Nëse ti e gostit me një cigare, në fillim ai do të nxjerrë nga xhepi një busull, për të përcaktuar se ku ndodhet jugu dhe vetëm pas kësaj do ta ndezë atë...

Unë qesha me të madhe dhe qëndrova në këmbë pranë pasqyrës me vrimë, për të kontrolluar se cili ishte ai. Domethënë, nëse ishte apo jo lexues. Në pasqyrë nuk reflektohej asgjë. Atje dallohej vetëm hija e tij, e shpërndarë nëpër libra, që ndodheshin në rafte. Këtu ai qeshi me të madhe, në të njëjtën kohë u gajas edhe hija e tij.

- Në këtë pasqyrë ai nuk do të kishte mundur të ruhej, - e përmbylla unë, - domethënë se është i vërtetë!

Kur të gjithë u ulën, Jaucini deklaroi triumfalisht:
- Ju nuk do ta besoni, por i ftuari ynë e njeh autorin e kësaj historie.

Paskëtyrefjalëve u bënë rrëmujë e pabesueshme, ndërsa Lena më pyeti drejtpërdrejt:

- Vallë, historia jonë paska autor? - në përgjigje, të gjithë filluan të qeshnin, kurse lexuesi tha se kishte, se ai e kishte parë një, apo mbase dy herë dhe gjithashtu së bashku me të kishte pirë kafe...

- A të tha ndonjë gjë?
- Po.
- Mbase të ka thënë diçka lidhur me ndonjë histori të tij?
- Pikërisht këtë. Ngjarja ka ndodhur kështu.

Përktheu: NIKOLLA SUDAR

AI NUK FRIKËSOHEJ NGA VDEKJA

tregim nga
Besa Kalaja

Plaku ishte tetëdhjetë vjeç kur u frikësua së pari nga vdekja. Çudi që s'ishte frikësuar më parë. Më bëri be që jo. Kaq më mjaftoi. Nejse në ato çaste, pasi më vonë fillova të dyshoj që kjo ishte e vërtetë.

Përpëlitesha brenda çarçafëve të bardhë si bora. Ai po endej në korridor, herë hynte në banjë e herë dilte, gjumi s'po e merrte. As mua. U mata të hap derën e ta pyes se a kishte nevojë për një çaj kamomile me xhenxhefil e limon se edhe mua me pihej, a një verë të nxehtë me kanellë, vetitë qetësuese të të dyjave po më ngacmonin.

E mbaja dorezën e derës me dorë po assesi ta hapja atë. Si po e mendonte vdekjen. Nëse i ka ardhur kaq vonë të frikësohet prej saj mos intensiteti i madh i frikës do ta mundojë. Tashmë po shqetësohesha për gjendjen mendore të tij. Gëëëërrc u dëgjua edhe njëherë dera. Hyri në banjë. Uji po rridhte më të madhe. Thua ta ketë harruar lëshuar. Do na marrë uji pas pak dhe pastaj frika nga vdekja merr fund. Prapë s'pata guxim ta hap derën. U ula në tokë dhe nuk e di çfarë po prisja, vdekjen e tij apo timen. Ajo kishte ardhur te unë në trajta të çuditshme, po më merrte gjithë fuqinë e trupit, këmbët po më ligështoheshin.

Ai fillikat me frikën e tij, unë fillikat me timen.

E mori dikë në telefon dhe po fliste me gjysmë zëri. Se pata të qartë ai tjetri që po fliste me të a pësoi ndonjë atak në zemër pasi kishte kaluar gjysma e natës. Po vazhdonte të fliste mirë ishte puna. Për pak e mora guximin e hapa derën dhe natyrshëm, pa asnjë prishje fytyre po qëndronte para derës sime.

- Desha të të thërrisja - më tha qetë, qetë.

- Edhe unë ka më shumë se dy orë që s'po e merrja guximin të dal nga dera, - i thashë.

- Për të njëjtat arsye, - ma bëri krejt i sigurt.

- Jo, - i thashë. Në këtë rast më shumë se për ta bindur atë kisha nevojë ta bindja vetën.

- Ka vdekur ai djali i ri te cepi i rrugës, më tha.

- Cili?

- Ai që sillte qumështin nga fshati.

- Kush të tha?


Ndjeva se po më ngushtohesh shpirti, më kapi temperaturë të cilën po e ndija në gjithë trupin.

-S'ka kush ma sjell më qumështin, - tha i nervozuar. - Ai qumësht me mbante gjallë, është i dhive të bjeshkëve, e di sa shumë e lëvdojnë qumështin e dhisë?

Më erdhi një forcë e tejnatyrshme, ia futa një shpullë fytyrës dhe e qita për toke. Më pa nga poshtë dhe po shtrëngonte dhëmbët. - Kot shtrëngon dhëmbët, - i thashë, - nuk mund të bësh asgjë, nuk ke fuqi më.



Skicë nga Bujar Kapllani



Fatos Kongoli

KAPITULLI I AMERIKËS

fragment nga romani
Botimet Toena, 2020

Një ndër shqiptaro-amerikanët më të shquar, që Rastësia e gjithëfuqishme e solli ta takoja atje, ku ajo më gatiste kurdoherë befasishtë e saj, në një aeroport, është zoti Shpëtim Telegrafi, autoritet shkencor në fushën e mjekësisë, i nderuar dhe i vlerësuar lart në SHBA dhe kudo nëpër botë.

Unë nuk e njihja zotin Telegrafi. Si doli, ai njihej me vëllanë tim Rolandin, dhe me kushëririn tim të parë, Engjëll Kongolin, në vitet kur kishte punuar në Elbasan njëkohësisht me ata të dy. Këtu po ia lejoj vetes t'i largohem pak temës, të hap një parantezë; gjej rastin, më në fund, të them dy fjalë për kushëririn tim të ndjerë, Engjëll Kongolin. Pa e ditur as ai vetë, Engjëlli ka ndikuar jo pak në formimin tim, si shembull i njeriut të aftë e të talentuar.

Kur e kam ndeshur për herë të parë Engjëllin, nga mesi i viteve '50 të shekullit të kaluar, ne banonim ende te shtëpia dykatëshe prej qerpiçi përballë ish-Shtëpisë së Oficerëve (më pas Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve), që e kam përshkruar te romani "Kufoma". Engjëlli sapo ishte kthyer nga Hungaria, ku kishte qenë student për mjekësi. Më e saktë është të thuhet se sapo e kishin kthyer, për shkak të ndërprerjes

së studimeve. Dëgjoja të thuhej se arsyeja që ia paskëshin ndërprerë studimet kishte qenë, ndër të tjera, një marrëdhënie dashurie e tij me vajzën e ambasadorit amerikan në Budapest! Tani mendoj se në atë kohë, ky fakt mjaftonte që ai të shihej nga të gjithë si "delja e zezë". Por unë sapo kisha shkelur në adoleshencë, ndërsa Engjëlli i përkiste botës së të rriturve. Për më tepër, unë ende nuk e dija kuptimin e metaforës "delja e zezë", për të përfytyruar mirëfilli ç'po i ndodhte atij. Gjatë atyre ditëve që bujti te ne, unë thjesht e shihja me një lloj kërsërie.

U miqësova me Engjëllin në një kohë tjetër, në vitet '68-'69, në qytetin tonë të lindjes, në Elbasan. Ai punonte si mjek radiolog në ambulancën e qytetit, unë në gjimnazin "Dhaskal Todhri". Kërsëria ime ndaj tij mbetej po ajo e dikurshmja, kur kishte bujtur në shtëpinë tonë. Nuk e teproj po të them se ai ishte për mua një personazh i jashtëzakonshëm. Jo se e shihja me syrin e shkrimtarit, si protagonist të ndonjë prej romaneve të mia të ardhshme. Në atë kohë unë vërtet kisha filluar të botoja ndonjë tregim, por isha ende një letrar i ri, as që më shkonte nëpër mend se do të shkruaja romane. Aq më pak ta shihja Engjëllin si protagonist. "Delja

e zezë" e dikurshme dilte jashtë skemave të kohës. Mbi të gjitha, unë ende nuk e njihja letërsinë e vërtetë, objektin e saj. Dhe, pavarësisht disa muajve shërbimi si mësues në një fshat të thellë malor të Elbasanit, ku hasa pamje krejt të ndryshme të realitetit, nga ato që jepeshin përmes propagandës së ditës, isha i papërvogë, pra nuk njihja as jetën. E, megjithatë, këto nuk më penguan që ta shihja Engjëllin si një personazh të jashtëzakonshëm.

Takimet me të në Elbasan, më përfitonin një kënaqësi të vërtetë. Përveçse mjek i shkëlqyer radiolog, siç e pohonin të gjithë, ai ishte mjaft i kulturuar, gllabërues librash, njohës i disa gjuhëve të huaja, të cilat i fliste rrjedhshëm. Një talent i vërtetë. Ai gjithmonë kishte shkëlqyer, edhe në Budapest, si student, ku ia kishin ndërprerë studimet, edhe në Tiranë, ku i kishte përfunduar. Dikush tjetër në vend të tij, me këto cilësi, do të kishte mundur të bënte një karrierë të sigurt. Në këtë pikëpamje Engjëllit nuk i kishte munguar asgjë. Djalë i një mjeku të nderuar, me emër të madh në qytetin e Elbasanit dhe Beratit, pushkatuar nga nazistët në dhjetor të vitit 1943 - rreth dy javë para se të vija unë në jetë - ai vetë kishte dalë partizan që në moshën katërmëdhjetëvjeçare. Mirëpo Engjëlli nuk kishte asnjë prirje për karrierë, përkundrazi. Shpesh, duke e çuar subjektivizmin tim, ndoshta në pikën e skajshme, them me vete se ai njeri plot dhunti, ishte lindur në vendin e gabuar, në kohën e gabuar. Sepse, si çdo qenie njerëzore, edhe ai kishte dobësitë e veta, e këto dobësi e çuan në burg.

Unë nuk ia zura kurrë me gojë Engjëllit vitet e burgut. Më vonë, pas vdekjes së tim ati, gjeta midis materialeve të lëna prej këtij të fundit, edhe një letër, që Engjëlli ia dërgonte nga burgu. As këtë nuk ia zura kurrë me gojë Engjëllit. Është një letër prekëse, pendesa e një njeriu të zënë në faj, ku kërkon ndjesë për shqetësimet që u ka shkaktuar të gjithëve, familjes së tij, të afërmeve, tim ati, të cilin e konsideronte në vend të babait.

Atë e arrestuan kur punonte si mjek në Gjirokastër, dhe e dënuan plot dymbëdhjetë vjet. Midis akuzave, me sa mbaj mend nga bisedat në familje, ishte edhe ajo për tentativë arratisjeje. Nuk më takon mua të merrem me faktin se sa qëndronin akuzat kundër tij, në çfarë rrethanash iu bënë, kush dhe pse ia bëri etj. E vërteta është se nga dymbëdhjetë vjet që e dënuan, Engjëlli kaloi në burg vetëm dy apo tre vjet. Fill pas lirit, qe vendosur në qytetin e lindjes.

Miqësinë dhe afërsinë tonë, jo thjesht si kushërinj të parë, ne e ruajtëm edhe më vonë, kur nga Elbasani ai erdhi dhe u vendos në

Tiranë. Po ashtu, vazhduam bisedat pa fund për librat, për letërsinë. Që nga viti 1996, unë banoja në një apartament, në zonën e quajtur "Pallatet 1 Maji". Në pallatet aty rrotull banonin edhe Kongolë të tjerë, motra e Engjëllit dhe dy vëllezërit e tij, pranë njëri-tjetrit, pranë meje gjithashtu. Në atë apartament ai jetoi deri në fund, kur pas disa problemesh shëndetësore u shua.

Dua ta mbyll këtë parantezë për Engjëllin me një konstatim. S'më ka ndodhur të ndesh ndonjë mjek që të mos ketë qenë njohës i stërholluar i letërsisë. Në mos në kuptimin që i japin këtij nocioni studiuesit, së paku që të mos ketë qenë lexues i rregullt, deri në gllabërues librash. Në këtë pikëpamje mendoj se ka ngjashmëri të shumta midis shkrimtarit dhe mjekut. Nuk duhet të jetë e rastit që disa shkrimtarë të përmasave botërore, fjala vjen Anton Çehovi, kanë qenë mjekë.

Atë ditë, kur zumë vend bashkë me Lilin në avionin e linjës Tiranë-Vjenë, unë nuk mund ta merrja me mend se personi në ndenjësën përpara nesh, ishte mjek, aq më pak një mjek mjaft i shquar urolog. Më tërhoqi vëmendjen thjesht sepse në ndenjësën pranë tij ishte ulur një e njohura ime e vjetër, të cilës tani ia mbaj mend vetëm emrin, e quanin Vera. Vera ishte një vajzë simpatike, me sy e flokë të zinj, ish-punonjëse në Shtëpinë Botuese "8 Nëntori". Duke qenë se "Naim Frashëri", ku punoja unë, për një kohë të gjatë ka ndarë të njëjtën godinë me Shtëpinë Botuese "8 Nëntori", ndodhte të shiheshim shpesh korridoreve apo nëpër shkallë etj. Vera kishte studiuar për gjuhë angleze dhe aso kohe punonte në redaksinë e përkthimeve. Nuk shiheshim dhe s'dinim asgjë për njëri-tjetrin prej një çerek shekulli.

Gjatë fluturimit për në Vjenë, mësova prej saj se ndodhej në Kanada, së bashku me një ish-kolegen time në gazetën "Drita", drejtoresha më e fundit e Shtëpisë Botuese "8 Nëntori", rrjedhimisht edhe shefja e saj më e fundit, Frida Idrizi. Po gjatë fluturimit krijova gjithashtu përshtypjen se burri fjalëpakë, me të cilin më prezantoi, ishte një i njohur i saj. Kjo përshtypje doli e pasaktë. Në Vjenë, për inerci, ne qëndruam bashkë për një kafë, dhe gjatë bisedës kuptova se takimi i Verës me atë person, kishte qenë po aq i rastit sa takimi me mua dhe nuk njiheshin. Tek pinim kafë, Vera e solli fjalën te romani im "Lëkura e qenit". Ajo më tha se ky libër i kishte pëlqyer shumë dhe kishte dëshirë ta përkthente në anglisht. Ajo më pyeti nëse unë isha dakord, që ajo ta përkthente romanin tim në anglisht. Të them të drejtën unë nuk i dija aftësitë e Verës në përkthimin e letërsisë artistike, s'dija që ajo të

kishte përkthyer ndonjë libër të kësaj natyre. Megjithatë, më shumë për mirësjellje, i thashë se nuk kisha ndonjë kundërshtim, përkundrazi, por nuk ngurrova t'i bëja një paralajmërim: të mos i hynje një pune të tillë pa gjetur më parë një shtëpi botuese. Me gjithë dëshirën e mirë të Verës, ky projekt nuk u realizua.

Më tej, për përkthimin dhe botimin në anglisht të romanit “Lëkura e qenit”, u interesua një shqiptaro-amerikane, zonja Eralda Lameborshi. Aktualisht, zonja Lameborshi jep leksione të “Letërsisë së krahasuar”, në “Stephen F. Austin State University”, në Teksas. Një ditë mora prej saj një *e-mail*, përmes të cilit shprehej me vlerësimet më të mira për romanin tim, kishte dëshirë ta përkthente në anglisht dhe kërkoi pëlqimin tim. Sigurisht, rashë dakord, madje, me kërkesën e saj, nënshkruam edhe një kontratë formale. Zonja Lameborshi, të cilën nuk pata mundësi ta takoja ndonjëherë, por komunikuam vazhdimisht përmes internetit, më vuri në dijeni se tashmë kishte përkthyer nja dy kapituj të librit, dhe ia kishte çuar një botuesi universitar. Më pas përktheu edhe sprovën time “Një ëndërr europiane mes Al Paçinos dhe Kavabatës”, të cilën e kishte gjetur po vetë. Këtë të fundit, si më shkroi, ia kishte paraqitur për botim një reviste. Mirëpo të dyja këto përpjekje të saj dolën pa sukses. Gjithsesi, përfitoj këtu edhe një herë ta falënderoj nga zemra.

Me gjithë kuptimin e fjalës, ka qenë një fat për mua që rasti e solli të njihesha atë ditë me zotin Shpëtim Telegrafi. Para se të zinin vend në avion për të vazhduar fluturimin drejt Nju-Jorkut, ai më dha kartëvizitën e tij. Kur ai më dha kartëvizitën, as që më shkoi nëpër mend se shumë shpejt do të më duhej ta përdorja atë në çastin e një krize akute, si thonë mjekët.

Nja dy-tri ditë pasi mbërritëm në Nju-Jork, tek bënim me Lilin ecjen tonë të zakonshme në mëngjes herët, te shëtitorja buzë oqeanit, urinova me gjak. Aty për aty nuk pata ndonjë dhimbje, madje fillimisht nuk desha ta besoja, mbase më kishin bërë sytë. Nuk i thashë gjë as Lilit.

Disa minuta më vonë urinova sërish dhe përsëri me gjak, pra shqisat nuk më gabonin. Meqë s'pata ndonjë dhimbje nuk u merakosa dhe aq, sërish nuk i thashë gjë as Lilit, por kur u ktheva në shtëpi s'munda të mos shqetësohesha.

Ishte ende shumë herët. Pa i bërë dot ballë tundimit, dhe gjithnjë pa i thënë Lilit asgjë, iu drejtova kompjuterit: desha të mësoja domethënien e urinimit me gjak. Hasa lloj-lloj interpretimesh, deri te kanceri i veshkave. Të them të

drejtën e humba toruan dhe mendja më vajt vetvetiu te doktor Shpëtimi, me të cilin isha njohur vetëm para dy-tri ditësh. Nuk e mbaj mend mirë nëse e mora në telefon, apo i dërgova një *e-mail*, ku ia shpjegoja gjendjen time, që ndërkaq po përkeqësohej, kisha filluar të ndieja edhe dhimbje, që dora dorës po bëheshin të forta. Fakti është se doktor Shpëtimi m'u përgjigj menjëherë. Ai më tha të shkoja tek ai në klinikën ku punonte, rreth orës dymbëdhjetë të asaj dite.

Klinika në fjalë ndodhej në Manhatan. Rajoni i policisë ku shërbente Doriani ndodhej gjithashtu në Manhatan, kështu që ai nuk e pati të vështirë për të na çuar mua dhe Lilin drejt e te doktori. Nuk do ta harroj kurrë kujdesin që tregoi ndaj meje ai njeri fisnik. Sapo e lajmëruan, erdhi në sallën ku qëndruam fare pak, dhe më kërkoi ta ndiqja drejt mjedisit ku priste pacientët. Atje më bëri edhe një eko të veshkave. Fjala ishte për gurrëza në veshka, një thërmijë kishte rrëshqitur në kanalin urinar, shkaku i dhimbjeve. Ai e nuhati se isha i trembur dhe për të më qetësuar më tha me shaka që të mos merakosesha, do të hiqja ca, por nuk do të vdisja! Dhe, para se të largohesha, më dha dy kutia të vogla, mbushur me hapje.

Dhimbjet më pushuan sapo u kthyem në shtëpi dhe piva hapjet, sipas udhëzimit të doktorit. Afër mbrëmjes, kur unë praktikisht nuk ndieja më as dhimbje, as nuk urinoja më me gjak, ai më mori në telefon. Më pyeti si isha, dhe unë iu përgjigja se isha fare mirë, hapjet e tij më kishin lehtësuar menjëherë, më kishin shpëtuar gjithashtu nga urinimi me gjak. Megjithatë, doktori nuk ngurroi të më jepte një

porosi: nëse ndieja prapë dhimbje të mbushja vaskën e banjës me ujë të ngrohtë dhe të zhytesha në ujë. Po ta shihja keq, të nesërmen të shkoja prapë tek ai, në klinikë.

Nuk doli nevoja. Më pas unë nuk pata asnjëherë një problem shëndetësor të kësaj natyre, ndonëse hapjet që më kishin tepruar i ruajta për një kohë të gjatë. Shënoj se ky ka qenë rasti i parë që m'u desh të shkoja te klinika në Manhatan. Them kështu sepse rreth një vit më vonë unë shkova përsëri atje. Pas një kontrolli dhe analizave në Shqipëri për prostatën, lindën ca dyshime dhe me porosinë e mikut tim të vjetër doktor Nestor Thereckës, unë vajta përsëri te doktor Shpëtimi. Doktori u tregua sërish i gatshëm të më ndihmonte dhe më shoqëroi te një koleg i tij i klinikës, një mjek amerikan, specialist i prostatës. Ky më vizitoi, u hodhi një vështrim analizave që kisha bërë në Shqipëri dhe më qetësoi përfundimisht: gjendja e prostatës sime ishte normale, në përputhje me moshën. Mbaj mend se në këtë vajtje të dytë te klinika në Manhatan, më shoqëroi Elda.

Përtej problemeve shëndetësore, kujtimi më i bukur i njohjes sime me doktor Shpëtimin është një tjetër vizitë, kësaj radhe jo te klinika në Manhatan. Një vizitë në shtëpinë e tij, ku ai na ftoi mua dhe Lilin të shkonim për drekë.

Doktori banonte në një nga lagjet më shik të Nju-Jorkut, lagje njerëzish të kamur, në zonën e quajtur “Upstate”. Takimin na e la te klinika në Manhatan dhe prej andej, me makinën e tij, vajtëm në “Upstate”. Një hapësirë e qetë, plot gjelbërim, e pyllëzuar.

Makina ndaloi para një vile dykatëshe, me një garazh të madh përbri, tipike amerikane. Atje na prit bashkëshortja e doktorit, me të cilën Lili u miqësua shumë shpejt. Madje, pasi drekuam, gruaja nuk ngurroi ta ftonte Lilin për të parë të gjitha ambientet e vilës së madhe. Kuptohet, Lili mbeti e mrekulluar.

Pasdite, atje mbërritën për të na marrë ne, Dori me bashkëshorten e tij, Irinën. Të zotët e shtëpisë këmbëngulën që ata të uleshin për të ngrënë dhe, ç'është e vërteta, ata nuk i bënë fort naze tryezës që u shtruan. Para se të largoheshim, në shenjë falënderimi, Dori i dha doktorit diçka që ky e vlerësoi jashtëzakonisht. Mendoj se ia vlen të ndalem në atë “diçka”, që doktori e vlerësoi aq shumë.

Im bir, si të gjithë oficerët e policisë së Nju-Jorkut, zotëronte një numër të caktuar kartash, me përdorim vjetor, në formatin e një kartëvizite. Këto ai mund t'ua jepte pjesëtarëve të familjes, apo disa të njohurve, që të mund t'i përdornin. Si dhe pse? Për t'ia paraqitur oficerëve të tjerë të policisë, në rast se ndaloheshin prej tyre për kundërvajtje, fjala vjen në shkelje të rregullave të qarkullimit, parkime të gabuara etj., e kështu t'u shmangeshin gjobave.

Sado e çuditshme të duket, kjo është e vërtetë. Kur ia kam treguar këtë fakt një mikut tim gjerman, ai nuk deshi ta besonte. Mirëpo, jo çdo gjë e Amerikës është e kuptueshme në Europë. As kjo shenjë solidariteti në familjen e madhe të policisë së Nju-Jorkut, që më shumë tingëllon si privilegj “brenda llojit”. Ja përse doktor Shpëtimi e vlerësoi mjaft kartën që i dha Doriani.



NDJEKJE TË
THINJURA

poezi nga
Azgan Berbati

IKJE TË PAKTHYEME

Një shi i lashtë mbërrin dhe rrëzohet mbi vdekjen e lumit,
Tërë shirat qajnë rrëzimin dhe vdekjen;
Rikthimet e pamundura i qan një grua
Mbi lumin që det s’do bëhet kurrë!

HESHTJE E PËRBOTSHME

Ra heshtja mbi botë
Si një pezaul i qëllimshëm,
Drita u zbeh, u bë e ftohtë
Për çdo të munguar, e çdo të pranishëm.

Disa thurën bejte;
Të çmendurit u panë dhe qeshën,
Disa numëronin vdekje
...vdekje thanë; dhe heshtën!

KUJTESË

Çeli kumbulla dhe këtë vit,
Ndoshta kishte çelur pranvera e s’e dinim
Të gjitha lulet; ishin ditët e një viti
Të largët, oh sa të largët,
Që kumbulla deshi t’a sillte sërish
...dhe njerëzit kurrë s’e kuptuan
Vitin e largët, lulet e ditëve
Kumbullën e vërtetë...
Një jetë të tërë, nën hijen e kajsisë.

LUFTË DHE IDENTITET

Asnjë trim s’e ka dëgjuar këngën e vet
Kurrë!
Mbas luftime dalin plot të tillë
Dhe bëhen “Ti” pa e ditur.
-E nëse lind një tjetër luftë,
Askush më nuk bëhet Ti
As si Ti!

SEKONDA I LINDI TË GJITHË
(Edhe Kohën)

Dhe sekonda aq e vogël
Lindi shekuj të tërë,
Andrra sa dy herë vetja,
Dhimbje, tragjedi, vdekje
Njerëz që e mendojnë veten:
“oh sa t’mdhenj”.

Edhe dashuritë, lumturitë, e t’mirat, sekonda i lind, i rrit
Krejt jetën,
Sekonda
e para dhe e fundit ngjithçka.

...

I donte fort kafshët;

Më fliste përherë për një kaproll të vogël
Që kurrë nuk u rrit.
Ndoshta i fliste fëmijëria.

Për një kalë që kurrë të zonë në pritë s’e lëshoi, po as
gra mbi të kurrë nuk udhëtuan.
Ndoshta i flisnin plagët e shpirtit, ngjarjet.

Më fliste për pëllumbin “e pabesë”
Për korbin e gjarpërin.
Ndoshta flisnin mitet, vitet, kujtimet, hallet.

Më fliste gjithmonë për një qen;
Legjendar besnik që kurrë qen s’e quajti!
Mbi të gjitha i fliste dashuria.

Më fliste dikur gjyshi im,
Më flisnin bjeshkët me radhë,
edhe sot më flet gjyshi
...ndonëse më rrallë!

NDJEKJE TË THINJURA

Ti do të ikësh
Si një mërzi e pashprehur,
Duke ma trembur nga krahët lumturinë
Siç trembet shpirti i një zogu në duart e fëmijës.

Ti do të bëhesh vjeshtë,
Që unë të vij fill pas teje
E të bëhem dimër,
Të ngrij ikjet tua,
Dhe kur të bëhemi bashk
T’i ndjellim plakjen njëri-tjetrit
Me pleq prej bore.

Ti do të bëhesh vjeshtë,
Që unë të thinjem pas teje.

KËNGA QË S’U KËNDUA

Rrëzohet perëndimi nën qiell,
Tërë shikimet rrëzohen mbas tij,
Si një vjeshtë e papritur,
Si një shpirt i trazuar,
Dhe unë këndoj pa zë shpeshherë
Për një shpirt, a mos ringjallet.
(A ka bota shpirt, vdekje a ka !?)
Edhe shirat këndojnë balada,
Këngë e vjetër kthimesh...

O perëndim, më vjen të këndoj
Por, zëri im s’po del...

FËMIJËRIA

Nuk janë këto shira të reja,
I kam parë diku
Një ditë të hershme,
i ndieja si sot.

Kështu më vjen shpeshherë
E vogla ime prej shiu,
Dhe ikën nëpër dekada,
Si troku i kalit të bardhë
Me frikën që s’kthehet më!

Unë e di;
E vogla ime prej shiu do të vijë sërish
Mbi trokun e kalit të bardhë,
Përtej xhamit përlotur me të mirën time;
Fëmijëri.

MALL

Tani që dita u zgjat,
Ikëm nga shkurti i dimërt,
I dimërt dhe pa dëborë.

Rrugët e vendlindjes më ngajnë,
Si pleq të kërrusur malli,
Që kërkojnë një fëmijë të humbur dikur,
Të rritur para kohe.

Tërë malltet e botës kalojnë andej
Për një dëborë të vjetër,
Për një pranverë të bardhë,
Për një fëmijëri të shkuar!

Tërë malltet e botës,
Mbi rrugët plot moshë,
Enden pa u shuar!...

PËRGJËRIM

Në verat e mia plot bjeshkë
Luajnë fëmijët me mall,
Kujtimet...

Tërë kafshët e egra më kujtohen,
Madje edhe njerëzit
Kur vrisnin veten në syrin e tyre,
(Dhe mendonin që kafshën vranë!)
Por amanet faleni
Përshpirtjen e kaprollit për besën tuaj!
Dhe veten keni falur
Në emrin e pafajësisë së tij!

...përgjërohet nga larg, një fëmijë gjahtari.



SELMA LAGERLÖF

Fjala në festën e Nobelit 10 dhjetor 1909

Lartëmadhëri! Të nderuar Zotrinj dhe zonja!

Para ca vitesh, po udhëtoja me tren për në Stockholm. Sa kishte rënë nata. Jashtë ishte errësirë dhe brenda në kupé ishte edhe më errët. Bashkëudhëtarët e mi po dremisnin secili në këndin e vet dhe unë e heshtur dëgjoja zhurmën e trenit, që lëvizte nëpër binarë.

Ulur në tren po mendoja për të gjitha ato udhëtime që kisha bërë për në Stokholm. Më së shpeshti kisha udhëtuar për diçka të vështirë. Kisha udhëtuar aty për të marrë diplomën, pastaj kisha udhëtuar me dorëshkrimet e mia për të gjetuar ndonjë botues. Kurse tani po udhëtoja për të marrë çmimin Nobel. Nuk mendoja se edhe ky udhëtim tani nuk do të ishte i vështirë.

Gjatë tërë vjeshtës unë kisha bërë jetën në shtëpinë time të vjetër në Värmland, në vetmi të plotë, kurse tani duhej të shfaqesha në mesin e shumë njerëzve. Më dukej sikur aty në vetmi isha bërë e ndrojtur ndaj jetës dhe lëvizjeve, shqetësohesha vetëm nga mendimi se sërisht më duhet të shfaqem jashtë me të tjerët.

Por në esencë kjo ishte një ndjenjë e mrekullueshme gëzimi që më ishte dhënë çmimi, dhe kërkoja që ta flakja shqetësimin duke menduar për ata që do të gëzoheshin shumë për gëzimin tim. Ndër ta ishin shumë miq të mi të vjetër, ishin vëllëzërit dhe motrat, dhe para së gjithash, ishte nëna ime plakë, që qënfronte në shtëpi dhe gëzohej që arriti ta përjetonte këtë ngjarje të madhe.

Menjëherë mendja më shkoi tek babai, ndjeva një mungesë të madhe për të, se nuk ishte më në jetë që të mund t’i tregoja se kam fituar Çmimin Nobel. E dija, se askush nuk do të gëzohej më shumë se ai. Asnjëherë nuk kam takuar dikend që të ketë treguar një dashuri dhe kujdes më të madh për letërsinë dhe shkrimtarët, dhe nëse ai tani do ta dinte se Akademia Suedeze më ka ndarë këtë çmim të lartë letrar ... Ndjeva një dhembje të madhe që nuk mund t’i tregoja për këtë gjë.

Secili që udhëton me tren sonte në errësirë, e di që, ndanjëherë vagonat për disa çaste lëvizin përpara çuditërisht qetë dhe pa lëkundje. Zhurma dhe tingujt ndalen, dhe buçima e vazhdueshme shndërrohet në një muzikë të qetë e të njëtrajtshme. Duket sikur vagonat e trenit nuk po shkonin mbi shina dhe binarë, por lëviznin lartë drejtë qiellit. Mu kur dëshiroja ta takoja babain, ndodhi diçka në atë rrugëtim.

Treni filloi të nxitonte përpara qetë dhe lehtë, sa mendoje se ishte e pamundur të ishte akoma në tokë. Dhe mendimet e mia filluan të loznin: “Imagjino sikur të udhëtoja tani për tek babai im në qiell ”Kam dëgjuar se kjo ju ka ndodhur të tjerëve, pse të mos më ndodhte edhe mua?”

Treni vazhdonte përpara pa zhurmë, në heshtje. Ndonëse shkonte me shpejtësi kishte edhe shumë për të kaluar, derisa të arrinte cakun, dhe mendimet e mia arritën para tij.

“Tani kur do ta takoj babain,” mendoja unë” ai me siguri rri ulur në një karrige luhatëse në një verandë dhe ka para një kopsht të ndritshëm, plotë me lule dhe zogj, dhe natyrisht është duke lexuar përrallën e Fritjofsit. Dhe kur të më shehë mua, babi e lë librin mënjane, i vë syzet në ballë , ngrihet dhe vie drejtë meje. Pastaj më thotë “ mirëdita” dhe “ mirë se erdhe” dhe “ Ashtu” a je ti duke kaluan kënde” dhe “ Si je çupëza ime” – krejtë sikur atëherë.

Vetëm kur u drejtua mirë në ulësen që luhatej, ai fillo të mendonte pse e kam kërkuar. “ Mos ka ndodhur gjë andej nga shtëpia”, më pyeti ai papritmas.

“Jo, baba, gjithçka është në rregull” Dhe unë përqipem t’ia japë lajmin, por pastaj dëshiroj që të pres pakëz, prandaj unë i bie paksa tërthorazi. “ Kam ardhur këtu vetëm të të lusë për një këshillë të mirë, i them unë dhe dukem e brengosur. “ Kam rënë në borxhe të mëdha”.

“Kam frikë se nuk do të marrësh shumë ndihmë nga unë për këtë gjë”, thotë babai” Mund të thuhet për këtë vend sikur për kopshtet e Värmlandit, që këtu ka gjithçka përveç parave.

Por nuk jam zhytur në borxhe për para” i them unë. “

Edhe më keq, pra” thotë babai. “ Më trego të gjitha tani prej fillimit, çupëza ime!”

“Nuk ka gjë pse s’ më ndihmon” them unë , “ ngase është faji yt që nga fillimi”. A të kujtohet se si uleshe zakonisht pranë klaviaturës dhe këndoje për ne fëmijët Bellmanin, dhe a të kujtohet kur na nxisje të lexonim Tegnérin, Runebergun dhe Andersenin disa herë gjatë një dimri? Në këtë mënyrë unë u futa në borxhin e parë. Baba, si do të mund t’i shpërblej ata, se ata më mësuan që t’i doja përrallat dhe heroizmat, atdheun dhe jetën njerëzore me tërë madhësinë e tyre por edhe me tërë dobësitë e tyre.

Kur e them këtë , babai drejtohet në karrigen lëkundëse dhe i qeshin sytë. “Gëzohem që të kam futur në këtë borxh” thotë ai.

«Po, ke të drejtë, baba” them unë, “ por duhet ta dishë se kjo nuk merr fund me kaq. Duhet ta dishë se unë kam një mori borxhesh te këtilla. Mos i harro të gjithë ata kavaljerët e varfër dhe të pastrehë që zakonisht silleshin rreth Värmlandit, në kohën e rinisë tënde, që luanin dhe këndonin balada! Atyre u kam borxh për aventurat e çmendura, qeshjet dhe shakatë e pafund.

Dhe mos harro të gjithë ata të moshuar që qendronin nëpër kasollet e tyre të vogla e gri në cep të pyllit dhe kanë treguar rrëfime për divat dhe o GRAT! Janë pra ata që më kanë mësuar sesi poezia mund të shtrihet përtej bjeshkëve të thepisura dhe pyjeve të errëta. – Dhe, baba, mos harro gjithë ata murgj dhe murgesha të zbehtë dhe syhapur, që kanë qëndruar nëpër manastire të errëta dhe kanë parë hije dhe dëgjuar zëra! Atyre u kam borxh për huazimet e thesarit të madh të legjendave, që ata kanë mbledhur. Dhe mos harro bujqët, që shkuan në Jerusalem!

“A nuk u kam shumë borxh atyre, ngaqë më kanë dhënë një guxim të madh për të shkruar? Dhe , baba, nuk janë vetëm njerëzit të cilëve u kam borxh, por edhe krejt shtazëve në tokë dhe zogjëve në qiell, luleve dhe pemëve – të gjithë së bashku më kanë rrëfyer fshehtësitë e tyre”.

Babai vetëm pohon me kokë dhe buzëqesh derisa unë i them këto, dhe nuk duket fare i brengosur. ” Duhet ta kuptosh baba se ky është një borxh i madh” them unë dhe bëhem gjithnjë e më serioze.

«Në tokë askush nuk di se si të lahet borxhi. Prandaj mendova se ju këtu në qiell e dini këtë.» – «Po , me siguri edhe e dimë këtë,» thotë babai dhe e merr këtë me lehtësi, ashtu si e kishte zakon. «Do të të japim këshilla për brengat tua. Mos ki frikë, fëmijë!

«Po , por, baba, por kjo nuk është e mjaftueshme” i them. «Unë u kam borxh të gjithëve, atyre që kanë lartësuar gjuhën, që kanë farkuar dhe formësuar veglat e mira dhe më kanë mësuar t’i përdor ato. A nuk u kam borxh të gjithë atyre, që kanë shkruar dhe krijuar para meje, që e kanë shndërruar në art të bukur rrëfimin e fateve njerëzore, që më kanë frymëzuar dhe mi kanë çelur rrugët? A nuk u kam borxh të shumëfishtë atyre që, në rininë e hershme më kanë përvetësuar me poezinë: norvegjezët dhe rusët e mëdhenj?

A nuk jam në borxhe, ngaqë pata mundësinë të jetoja në një kohë, kur letërsia e vendit tim kishte arritur lulëzimin më të madh, se pata mundësinë ta njoh princin prej mermeri të Rydbergut, botën poetike të Snoilskyt, arkipelagun e Strindbergut, jetën e rëndomtë të Geijerstamit , artin e Tor Hedbergs, njerëzit bashkëkohorë të Anne-Charlotte Edgrenit dhe Ernst Ahlgren, poezitë e Helena Nyblom, Lindjen e Heidenstamit , historitë e gjalla të Sophie Elkan, këngët e Värmlandit të Frödingut, legjendat e Levertinit, pikturat e lëndinave të Hallström Thanatos dhe Karlfeldit si dhe shumë krijime të tjera të reja, frymëzuese për garim dhe të frytshme për ëndërrim?»

«Po, po,» thotë babai. «Ti ke rë drejtë, ti ke shumë borxhe, por mund tu bësh ballë.»

«Nuk besoj, se ti e kupton vërtetë se sa të vështirë e kam, baba, them unë. «Ti mbase ke harruar që u kam borxh edhe lexuesve të mi. I gjithë falënderimi im u shkon atyre: që nga

mbreti i moshuar dhe djali i tij i ri, që më dërguan të bëja një praktikë në jug, deri te nxënësit e vegjël në shkollë, që gërvishën bashkë një faleminderit për Nils Holgersson? Çfarë do të bëhej me mua nëse ata do të zgjidhnin të mos i lexonin librat e mi? – Nuk duhet t’i harrosh as ata, që kanë shkruar për mua. Kujto këtu kritikun e madh danez, që më solli shumë miq në tërë vendin e tij vetëm me disa fjalë! Dhe mendo për atë, që tani ka vdekur dhe që ka përzier pijen e tij artistike me dhembjen dhe gëzimim , më shumë se që kemi bërë të gjithë ne këtu para kohës së tij!

Mendo për të gjithë ata, që në shtet të huaj kanë punuar për mua! U kam borxh, baba, edhe atyre që më kanë lavdëruar , edhe atyre që më kanë kritikuar.

“Po, po ,» thotë babai, dhe unë mendoj se ai nuk duket tani i qetë. Ai fillon ta kuptoj se nuk do të jetë e lehtë për të më këshilluar.

“Mos harro të gjithë ata që më kanë ndihmuar, baba!» them unë «Mos harro miken time besnike Esselde, që tentonte të hapte një rrugë për mua, kur askush tjetër akoma nuk guxonte të besonte në mua! Mos e harro atë. Numrin e madh të atyre që kanë ndihmuar krijimtarinë time dhe mbrojtur punën time! Dhe mos harro mikun tim të mirë dhe bashkëudhëtarin, i cili jo vetëm më solli në jug duke më treguar mrekullinë e gjithë artit, por edhe ma bëri tërë jetën më të ndritur dhe më të pasur! Dhe mos harro gjithë dashurinë, që më ka përcjellur, tërë atë nderim dhe mirënjohje! Nuk mund ta imagjinosh, që mua më duhet të vija tek ti për të mësuar se si t’i paguaj këto borxhe?»

Babai ka ulur kokën dhe nuk duket aq me shpresë si në fillim. «Sigurisht që mendoj se nuk do të jetë aq e lehtë për të të ndihmuar, vajza ime,» thotë ai. «Por tani mbase këtu mori fund?»

“Jo, deri këtu edhe kam mundur ta shtyjë vetë,» them unë. «Por tani së shpejti vie më e vështira. Për këtë arsye, unë isha e shtrenguar të vija tek ti, që të më japësh një këshillë.

«Nuk mund ta marrë me mend, që ti je futur në borxhe edhe më të mëdha” thotë babai.

“Lamtumirë,» i them unë dhe i tregoj për «atë «.

“Kurrë nuk mund ta besoj, se Akademia Suedeze ...” thotë babai. Por në atë çast më shikon, dhe atëherë e kupton se “ kjo” është e vërtetë. Dhe fillon t’i drejtohet çdo rrudhë e fytyrës së tij të mplakur, dhe sytë i përlohen.

“Çfarë t’ju them atyre, që kanë marrë këtë vendim, dhe atyre që më kanë nominuar për këtë çmim?» them unë.

“Se , mos e harro për këtë, baba, : nuk janë vetëm nderimi dhe paratë, që ata më kanë dhënë. Ata kanë pasur një besim të mirë në mua, sa kanë guxuar të më shpërblejnë para gjithë botës. Si do të mund ta shlyej këtë borxh falënderimi?”

Babai qëndron duke menduar paksa, pastaj i fshin lotët e gëzimit nga sytë, dridhet dhe godet me grusht kornizën e karriges. «Nuk dua të qëndroj këtu më duke menduar në gjëra, për të cilat askush , as në qiell e as në tokë, nuk mund të japë përgjigje,» thotë ai. «Nëse ti ke fituar Çmimin Nobel, atëherë unë nuk brengosem për asgjë, dua vetëm të gëzohem.»

Lartëmadhëri! Zotërinj dhe zonja! Meqë nuk mora përgjigje më të mira në pyetjet e mia, atëherë nuk më mbetet tjetër, veçse t’ju lus ta ngre me ju këtu një dolli falënderimi, që unë kam nderin ta propozoj për Akademinë Suedeze.

Përktheu: QERIM RAQI





Vox in deserto! (Zë në shkretëtirë)

REFLEKSIONE MBI LIBRIN
“ÇAMËRIA, TOKA PA NJERËZ,
NJERËZIT PA TOKË” TË AUTORIT
HYQMET ZANE

Nga Prof.Dr. Emine Sadiku

„Vox in deserto“ është kjo thirrja e Hyqmet Zanes për vëmendje e drejtësi. Është ndoshta i vetmi zë sot në Shqipëri që vazhdon të apelojë me konsekuencë dhe përkushtim për kauzën kombëtare çame.

Shkrimet e përmbledhura këtu përbëjnë një ansambël tematik që e përshkon si fill i ndritur mendimi se çështja dhe kauza çame ka pasur dhe ka luftëtarët e vet që nuk do ta reshtin luftën deri në triumfin e saj.

H. Zane ka meritën e padiskutueshme të grumbullimit të zellshëm të një materiali të bollshëm për bëmat, aktet dhe aksionet genocide të kohëve të ndryshme ndaj etnosit shqiptar çam. Këtu përfshihen rrëfime të dëshmitarëve okularë, të dhëna e fakte nga dokumente autentike që rrjedhin e lidhen direkt me situatat genocide. Në çdo shkrim është i pamungueshëm pozicionimi, qëndrimi subjektiv i autorit. Materialet e grumbulluara në këtë vëllim për nga tipologjia e teksteve

kanë natyrë historike publicisike. Pothuajse në çdo shkrim del publicisti që shfaq para opinionit të përgjithshëm të vërtetat mbi qëndrimet politike, mbi pazaret qeveritare, padrejtësitë dhe absurditetet në marrëdhëniet ose në bisedimet greko-shqiptare. Autori nuk ngurron të kritikojë e të denoncojë, të zbulojë hipokrizinë e qarqeve të larta diplomatike të të dyja palëve. Siç lavdëron njëherë qëndrimin mbi çështjen çame të kryeministrit Edi Rama në Athinë, e kritikon atë më pas për mungesë konsekuence. Objekt i veçantë kritikash e sulmesh janë pohimet e qeveritarëve të lartë grekë që duan ta fshijnë çështjen çame nga analet e historisë. Krahas dhelpërive e diplomacive perfide greke autori stigmatizon dhe indeferentizmin shqiptar, angazhimin e vakët të strukturave çame.

*Për të dhënë një ide më të qartë e më të plotë të këtij vëllimi me artikuj tejet interesantë po ndalemi në disa

episode e momente që theksohen në ansamblin e shkrimeve të këtij vëllimi.

Genocidi ndaj popullatës çame

Autori H. Zane këmbëngul me argumente se reprezaliet, denigrimi, dëbimi, persekutimi, vrasjet e therjet e çamëve nga grekët (me mirëkuptim dhe mbështetje të qeverisë greke) ishin tamam një genocid, një shfarosje në masë e njerëzve të pafajshëm. Ngjashmëria me holokaustin e hebrenjve para dhe pas luftës së dytë botërore është e madhe në shumë pikëpamje. Për të mbështetur më tej mendimin e autorit për genocidin ndaj çamëve do të sjell disa thënie autorësh të ndryshëm, shqiptarë dhe të huaj. Studiuesi famoz, profesori i nderuar S. Repishti, paraqet me saktësi shkencore e bindëse historinë e asaj treve aq te keqtrajtuar, Çamërisë, nga qeveritë, politikat greke e më gjerë. Dokumentacioni dhe retorika e tij nuk flasin, por ulërijnë. (S. Repishti, Referat „Me rastin e 70-vjetorit të masakrave greke në Çamëri“)

Masakrat, dëbimet, diskriminimi ndaj çamëve përbëjnë një genocid në kuptimin klasik të termit. Përcaktimin më të mirë të këtij termi e bën filozofi gjerman Karl Jaspers, ai që e vuajti vetë tmerrin e një deportimi të mundshëm, meqë Gertruda, gruaja e tij, ishte hebre. Pilulat e helmit i mbanin gati, në rast se do të vinin për t'i marrë. Në bisedën e tij me gazetarin Rudolf Augstein (der Spiegel, 1965) ai e specifikon kuptimin e termit „genocid“: „Krim i shfarosjes në masë (krim kundër njerëzimit) do të thotë t'i japësh vetes të drejtë që të vendosësh se cilat grupe etnike lejohen të jetojnë në një vend dhe cilat – jo. Dhe këtë të drejtë ta realizosh me dëbime e shfarosje. Sot kjo quhet genocid.“ (Jaspers, K. : Für Völkermord gibt es keine Verjährung“ „Për genocidet nuk ka amnisti“, München, 1979, f. 104)

Për genocid kundër çamëve flasin dhe autorë të huaj. S. Repishti citon diplomatën amerikan në Athinë, prof. Ëiliam Mac Neil: **Banda të armatosura të gjeneralit Zervas do të formonin njësi të rregullta të quajtura „Albanochtones“ (killers of albanians) për shfarosjen fizike të kësaj popullsie. Më shumë se 23 000 shqiptarë, që patën fatin t'i shpëtojnë kësaj masakre, kaluan kufirin gjatë viteve 1944- 1945 dhe gjetën strehim në Shqipëri ku jetojnë dhe sot.** (The Greek Dilemma ëar and Altermath, 1947, London)

Ose: **„Filloi një persekutim i popullatës çame në qytetin Paramthi. Vetëm këtu humbën jetën 300 çamë. Popullata në masë u drejtua në veri, nga Filati dhe në katër krahinat përreth. Në shtator u përsëritën luftimet. Sapo hordhitë e Zervës e pushtuan Filatin, filluan dhe këtu përndjekjet dhe masakrat.“** (Ein kurzer chronologischer Überblick, Ëikipedia)

Mund të ndaleshim në shumë shembuj e ilustrime që realizojnë dhe tejkalojnë tabllonë e një genocidi. Për të bërë genocid duhen forca të caktuara, të afta për krime të tilla monstruoze. Napoleon Zervas me shpirtin kriminel, që e karakterizonte, arriti të krijojë

hordhi me persona, me qenie të llojit të vet. Këto qenie përbindshore iu vërsulën si qen të tërbuar çamëve të pambrojtur duke bërë vrasje, therje e veprime makabre. E keqja, që ndodh dhe përsëritet në botë ka një peshë e një domethënie të tillë negative, sa ka tërhequr vëmendjen dhe është bërë objekt i studimeve të ndryshme filozofike. Fakti, që filozofët i janë drejtuar njerëzimit me teoritë dhe postulatet e tyre mbi të keqen, flet për ekzistencën e së keqes si një kërcënim i përhershëm e me viktima të shumta. Filozofi gjerman, kolosi Imanuel Kant, e trajton këtë dukuri nën emërtimin „e keqja radikale“. Për Kantin e keqja është radikale sepse ajo buron, i ka rrënjët në natyrën njerëzore. Në natyrën njerëzore gjendet dhe predispozicioni për të bërë mirë dhe prirja për të këqia. Kanti dallon prirjen kafshore të njeriut si qenie biologjike dhe predispozitat njerëzore si qenie të arsyeshme. E keqja, sipas Kantit, është një zgjedhje e lirë e njerëzve në kundërshtim me ligjet morale. Ndërsa Kanti synon të përcaktojë teorikisht rrënjët e së keqes, filozofja, Hannah Arendt, e trajton të keqen si një akt maksimal kundër njeriut, një veprim antinjerëzor pa kufi. Me konceptin e Kantit „e keqja radikale“ ajo synon të shpjegojë holokaustin si model mendimi e veprimi që qëndron në bazë të shfarosjes masive (Arendt, Hannah: Elemente und Ursprünge totaler Herrschaft, München, 1966, f. 941)

Duke e analizuar më tej konceptin në fjalë ajo shkruan: **„E keqja radikale është diçka që nuk duhej të ndodhte, me të cilën nuk mund të pajtohesh, që nuk mund të pranohet në asnjë mënyrë dhe mbi të cilën nuk mund të heshtet... Pasojat e saj janë të paparashikueshme dhe nuk ka dënim në botë që të jetë adekuat për të.“** (Arendt, Hannah: Elemente und Ursprünge totaler Herrschaft, München, 1966, f. 960)

Ja një copëz material dhe pyetja: a i përmbush ndodhia kushtet e të qenit „e keqe radikale“:

Këtu pranë, – dhe ajo më tregoi vendin, - është vrrarë një familje e tërë, 9 ose 10 vetë. Kishte mbetur i gjallë një fëmijë i vogël që ishte pak më shumë se një vjeç. Ai kërkonte të pinte sisë nga gjiri i nënës që kishte vdekur. Një nga zervistët tha se na ka shpëtuar gjallë një kulish mysliman dhe u bë gati ta vriste. Një shoku i tij i tha: mos e bëj këtë. Une s’kam fëmijë dhe do ta marr ta rris. Por zervisti i parë nuk deshë ta di dhe e vrau. Tri herë pushka nuk i ndezi. Pastaj e theri me thikë...”

A mund të ketë aparat njerëzor perceptimi që të mos e rrokë këtë ndodhi si krim-llahtari, si të keqe monstruoze? Kësi veprime demoniake kryhen nga një racë e veçantë njerëzore së cilës i përket:

Napoleon Zervas

Siç del nga shkrimet e përmbledhura në librin në shqyrtim të H. Zanes, N. Zervas si ushtarak “u afirmua me trimërinë” e treguar në krimet apokaliptike ndaj popullatës çame. Para këtij aktiviteti ai ishte një ushtarak

problematic, i përjashtuar disa herë nga ushtria greke.

(Brockhaus Enzyklpädie, Eiesbaden, 1974, Band 20, f. 662)

Para luftës së parë botërore Zervas vijoi një shkollë kadetësh në Athinë prej nga u përjashtua pas dy vjetësh si dembel dhe i padisiplinuar.

Si politikan, kur dolën në dritë informacione mbi bashkëpunimin e tij me pushtuesit gjermanë, ai u detyrua të dorëzojë karrierën politike. Nga politikanët e majtë grekë ai akuzohet për spastrim etnik, për dëbimin dhe shfarosjen e çamëve, operacione me shumë viktimë nga popullsia civile. (Napoleon Zervas, Ëikipedia, gjermanisht)

Drejtësi !

Një tematikë e rëndësishme e shkrimeve të H. Zanes është kërkesa, lufta për drejtësi. Se genocidi çam, edhe pse është denoncuar disa herë nga instanca, institucione, persona në zë, nuk është përballur asnjëherë me drejtësinë, asnjë gjykatë ose forum juridik nuk ka dalë me verdikte për t'i dalë në krah popullatës çame, pre dhe viktimë e përndjekjeve dhe genocideve. H. Zane i drejtohet madje dhe kryeprokurores së Gjykatës së Hagës, Karla del Ponte. Ajo, që ka shfaqur sensibilitet të veçantë ndaj krimeve të luftës, për çështjen çame, nuk pipëtin.

Autori është kthyer disa herë në përmendoren e ngritur nga grekët “në nderim” (!?) të Napoleon Zervës. Ata, që duhen dënuar për genocid, përjetohej me përmendore. Lidhur me dënimin e genocidistëve Karl Jaspers në bisedën e famshme me gazetarin e Spiegel, Rudolf Augstein, thotë: *“Askush nuk ka të drejtë të gjykojë dhe të vendosë që një grup etnik të mos jetë më në vendin (truallin) e vet. Ai/ata, që nisen nga gjykime e vendime të tilla dhe me forcë ndër marrin shfarosjen e popullatave, ai/ata kanë kryer një krim krejt të veçantë. Sepse veprojnë kundër principit themelor mbi të drejtën e ekzistencës njerëzore. Ata injorojnë të drejtën e çdo njeriu për të ekzistuar. Duke ngritur dorën kundër këtij principi-bazë, ata nuk meritojnë të jetojnë midis njerëzve të tjerë... Edhe nëqoftëse nuk ngrenë padi të afërmit e viktimave të masakrave, duhet themeluar një instancë e veçantë për të gjykuar rastet kur një grup njerëzish shfaros një grup tjetër. Do të ishte në interesin publik të njerëzimit që ata, që e bëjnë ose e kanë bërë këtë, të dënohen me vdekje.*

Edhe kundërshtarët e dënimit me vdekje do ta pranonin një dënim të tillë në raste krimesh të tilla që shfaqen me dimensione krejt të veçanta.” (Jaspers, K.: Für Völkermord gibt es keine Verjährung, München, 1979, f. 104-105)

Sot në Europë nuk flitet më për dënime me vdekje, por thënia e filozofit kolos, Jaspers, që ka zhvilluar një eksperiencë, një tmerr, tmerrin e njeriut që pret nga dita në ditë deportimin për shkak të gruas hebre, ka një domethënie e një vlerë të veçantë. Ai e di shumë mirë çdo të thotë holokaust, çdo të thotë genocid.

Ngritja e dy përmendoreve, përjetimi në to i figurës së Zervas, është një fyerje dhe një provokim për popullatën çame, që e pësuan tragjikisht nga ai dhe hordhitë e tij.

Autori akuzon dhe fuqi të tjera europiane që i nxitën dhe i mbështetën masakrat ndaj çamëve.

Lidhja nacionale republikane greke, EDES, e themeluar nga Zervas në vitin 1941, pas lufte u pozicionua në anën e aleatëve dhe me urdhëresë të tyre vijoi operacionin kundër çamëve. Urdhërat për këto operacione vinin nga shtabi i përgjithshëm i aleatëve në Aleksandri, Egjipt. Shumë oficerë britanikë shërbenin si ushtarakë ndërlidhës të EDES për koordinimin e operacioneve kundër popullatës çame. (Ëikipedia, Camen, gjermanisht)

Të projektosh fajin e pjesës tek e tëra, të individëve të veçantë te i gjithë grupi, të përgjithësosh dhe të fajësosh gjithë etninë është e padrejtë dhe kriminale. (Ein kurzer chronologischer Überblick, Ëikipedia, gjermanisht)

Një akuzë të fortë ngre autori edhe kundër disa veprimeve aventureske të sotme të palës greke që nuk pranojnë hyrjen në Greqi të personave të lindur në Çamëri. Me ç'të drejtë? Situata të tilla nuk kanë asnjë shpjegim në absurditetin e tyre. Këtu do të vliente ajo thirrja e thekshme latine: *O tempora, o mores!*

Po e mbyll këtë paragraf me fjalët e H. Zanes: “Ne sot jetojmë e mendojmë edhe për kauzën tonë, duan apo s'duan grekët, u vjen mirë apo nuk u vjen mirë pushtetarëve apo akademikëve që sillen privatisht me çështjen kombëtare.” (Artikull: e martë, 18 shtator, 2018)

Avantazhet dhe disavantazhet e historisë

Shpesh pyes veten: ku e gjetën çamët e dëbuar nga vatani i tyre, prindërit dhe të afërmit tanë, ne vetë forcën për të mbijetuar. Siç thotë dhe thekson autori, H. Zane, realitetit, që gjetën çamët në Shqipëri, ishte gjithashtu armiqësor ndaj tyre. Persekutimi i çamëve në Shqipëri vijoi herë me metodat greke (sa „grupe armiqësore“ çame “u zbuluan” dhe u asgjësuan mizorisht, me sojë e me fis), herë me metoda të tjera. Gjithçka rridhte në një atmosferë nënvlerësimi dhe përbuzjeje ndaj çamëve. Por ne mbijetuam e do të mbijetojmë. Mbijetesa jonë lidhet, së pari, me shpirtin tonë punëtor e luftarak, me vitalitetin tonë që ka triumfuar gjithnjë, me mirësinë tonë pakufi. H. Zane i kushton pjesë të veçanta në librin e tij jetës dhe kulturës çame. Janë mbresëlënëse përshkrimet e tij mbi ato shtëpitë e bukura çamërishte. Të veçanta janë këngët, vallet, tërë folklori çam që shquhet për një origjinalitet tronditës (kujtoni këngën e Çelo Mezanit, tumankuqen etj.). Pjesë e kulturës çame është dhe gjuha e bukur çamërishte me pasurinë dhe koloritin e saj të veçantë në hartën dialektologjike shqiptare.

Në pikëpamje psikologjike mbijetesa jonë shpjegohet me një lloj distancimi dhe një lloj mbylljeje. Me intuitën e tyre të ndjeshme çamët e kuptuan se nuk mund të mbeteshin robër të historisë tragjike dhe as të trazirave psikologjike

të kohëve të reja. Ata përvetësuan shprehinë, zakonet e tërheqjes, qoftë dhe formale, nga e keqja që i mundonte, distancimin nga ajo. Dihet që ky është një proces psikologjik tepër i vështirë. Edhe me anë të seancave profesionale psikoterapeutike arritja e një ekuilibri shpirtëror është tejet i vështirë. Sigurisht faktori „kohë“ luan rolin e vet. Kjo më kujton një thënie të shkrimtarit Vath Korreshi: „Kur do të vijë një ditë që ta shoh ndodhinë nga larg, nga tangentja e botës“. Për më tepër një distancim i tillë është dhe konform filozofisë së Nietzsche- s mbi përfitimet e dëmet e historisë.(Nietzsche, F.: Vom Nutzen und Nachteil der Historie, në „Unzeitgemäße Betrachtungen“, Kröner-Verlag, Stuttgart, 1964, f. 95- 197)

Sipas Nietzsches mbetja peng e historisë, teprimi me historinë, përmbytja nga historia, ngarkesa e përhershme shpirtërore e prodhuar nga historia „e prish forcën plastike të jetës, njeriut nuk i mbetet gjë tjetër vetëm të ushqehet shpirtërisht nga e kaluara.“ (f. 191) Si mjete shpëtimi nga teprimi me histori Nitzsche propozon: „Unhistorisch“(pahistori), me këtë koncept mendon „harrimin“ dhe „Überhistorisch“(mbihistori). Me këtë nënkupton terapinë nëpërmes artit dhe fesë.

Kështu në familjet tona flitej shumë rrallë për ngjarje konkrete ngjethëse. Po kur ndodhte kjo, ngjarjet e treguara ishin të paharrueshme. As e kam harruar dhe as kam për ta harruar një rrëfim të nënës sime kur u gjendën në Delvinë pas dëbimit nga Çamëria. (Sigurisht, nuk shkuan pas gjermanëve siç thonë shumë politikanë grekë). Rrëfimi më kujtohet në ligjëratë të drejtë: ***„Atje m'u sëmur nana. Me mundime i gjetëm një doktor. I dhamë dhe ilaçe. Ishte më tepër adhap i shpirtit se sa i trupit. Nuk bëri asnjë javë sëmure dhe vdiq. Ishte 54 vjeç. Ne filluam ta qajmë me bolori. Por e qara na mbeti në grykë. Vandalitë na u vërsulën e nuk na lanë të qajmë: ‘Doni dhe të qani, nuk shikoni hallin që ju ka zënë.’ E***

varrosëm nanën sido - kudo, në truall të huaj, larg shtëpisë sonë që atëherë nuk na e merrte mendja se nuk do ta shikonim më...”

Bashkë me distancimin në kultivua dhe një lloj mbylljeje të shpirtit. Në fund të fundit kujt i duhet liria pa kufi? Pothuaj askujt. E mësuam shpirtin të jetojë me kufizime. Ndoshta vuante në ato situata, por mendoj se kështu gjeti qetësinë shpirti ynë i trazuar.

Përfundime

Është një meritë e veçantë e autorit H. Zane që ka mundur të grumbullojë material nga dëshmitarë okularë të genocidit grek. Ata po pakësohen gjithnjë e më shumë. Nuk shoh më në rrugët e qytetit gra-nana të moshuara, me tumane e napë. Duket sikur i përpiu përjetësia. As baballarët tanë nuk jetojnë më. Por tregimet e tyre jetojnë të përmbledhura në këtë libër sa historik aq edhe kontemporan.

Hyqmet Zane shquhet për zërin e fortë në mbrojtje të kauzës çame në kushtet kur ajo sulmohet në mënyrë perfide nga politika greke dhe injorohet nga politika shqiptare dhe nga struktura që mund ta mbështesnin atë.

Autori, Hyqmet Zane, është konsekuent në përpjekjet e tij për të zgjuar e sensibilizuar forca të caktuara që mund të shprehen e t'i shërbejnë çështjes çame.

Ai është një kritik i fortë ndaj qëndrimeve antishqiptare greke që përdorin çdo mjet për të injoruar çështjet dhe problemet tona kombëtare, nganjëherë edhe duke kërcënuar (“rruga për në BE kalon nga Athina” etj.)

Lexuesi çam dhe çdo lexues tjetër do të gjejnë në këtë libër një informacion tejet interesant, historik dhe aktual, do të njohin forcën e përkushtimit, fuqinë e mërisë ndaj së keqes dhe dashurinë pa kufi për viktimat e pafajshme të persekutimeve.

Edhe pse zëri i tij sot është “Vox in deserto” (zë në shkretëtirë) ai paralajmëron ardhjen e drejtësisë, e kohëve më të mira.

Bonn, 16 mars 2019



TEODOR KEKO OSE MË MIRË DORI

ese nga Roland Gjoza

Jashtë dynden mjegullat e Hudson Riveri-t. Xhamat e mëdha të starbucksit ku po pi një kafe duken çuditërisht si të përmytura me zhivë. Kisha hequr xhakët me inicialet e Oficer Security dhe ia kisha mbathur. Kishte vdekur Dori. Duke shfletuar gazetën në internet kisha ndeshur lajmin si një aksident. Madje ndieja një si shije gjaku. Dhe xhamat e dritareve që binin nga Hudson Riveri ishin përmytur nga zhiva e mjegullave përjashta. A e dini se po ti thoje poet ai do të qeshte, se nuk e mbante veten për poet, po ti thoje tregimtar, ai sërish do të qeshte, se nuk e mbante veten për tregimtar, po ti thoje romancier ai do të bënte shaka, do të tallej me veten, se nuk e mbante veten për romancier, po ti thoje gazetar, do të merrte një shprehje kinse të menduar, do të tallej sërish e papritur do të thoshte; po, unë jam gazetar. Të tjerat janë mbushje kohe, po unë në të vërtetë jam gazetar. Atë di ta bëj. Më vjen dhe e bëj.

E kisha redaktor të një prej librave të mi. Dy herë nuk e gjeta në zyrë. Ma plase shpirtin Dor Keko. Ai pinte poshtë me miq dhe më shikonte dhe bënte sikur se kishte mëndjen. Shef kishte Zija Celën. As bëhej fjalë t'i thoja gjë Zijait, aq skrupuloz në punën me librin, sikur kishte lindur me libër. Patjetër me një kopje të Biblës, se nuk e di pse më dukej pak Krisht.

Ç'kujtoj kështu? Ai ka vdekur. Shumë i ri. Dhe poezinë e fundit, më të mirën, e ka për ne mjeranët që e shpërdorojmë shpresën, e kemi kthyer në xhele. Tani që do vdes, thotë Dori, dita është vërtetë kaq e bukur dhe lulet me kaq shumë aromë (nuk mund t'i recitoj siç janë, se poezitë nuk i mbaj mend, madje as një varg të vetëm.), pra ai na thotë ne truthtarëve me ndjesinë makute të të përjetshmit të mërztishëm, rizbulo mrekullinë te gjërat e vogla që i ke harruar, sepse ia vлека të jetoje.

Iku si një turist. Kështu e përfytyroj. Po pse po vonohet?

Marr dhe një kafe të dytë. Një pëllumb hyn nga dera drejt e brenda. Janë të zakonshmit e Manhattanit që na kalojnë nëpër këmbë çdo ditë dhe rrallë fluturojnë. Sa përmenda atë shprehjen; po pse po vonohet, ja ku erdhi ky pëllumb.

Xhanfise Keko, një grua e shkurtër, e hajthme, pothuaj e vetmuar, më ndaloi te korridori i katit të dytë të Kinostudios. Më tha se kishte nevojë të më merrte një mendim. U çudita. Atëherë si rishtar i panjohur që sapo isha kthyer nga Puka, nuk isha mësuar thujse fare me një kujdes e vlerësim të tillë. Dori mbaroi universitetin, po nuk di ku ta çoj; te Drita, Zëri i Popullit, apo këtu? U skuqa, vërtet u turbullova

dhe gati e keqkuptova, se fillimisht mendova keq, me njëfarë mllëfi verban, që na kapullon pa ndonjë arsye të fortë. Ajo ishte regjisore e madhe e filmave për fëmijë, e pa konkurueshme, i shoqi Endri Keko, dokumentarist i shquar, mik i Agollit dhe i shumë figurave të tjera me peshë në atë kohë, dhe ja, të bijtë e gjenin të shtruar. Dhe ky Dori lutej të zgjidhte. Kur mendoja Pukën, tetë vitet e një vetmie të madhe dhe vuajtjet e pafundme, se si më vinte. S'po flet, me tha ajo, me atë ëmbëlsinë e saj të zakonshme. Po ju ç'mendim keni? e pyeta. Në Zërin e Popullit do të ishte më mirë. Ai mund të bëhet gazetar i mirë. Po ka nevojë dhe për pak diktat. Është ca i lëvizshëm, i merr lehtë gjërat, po të bën shumë për të qeshur. Po ai vetë ku do? e pyeta sërish. Te Drita. Larg politikës, më thotë. Unë e di pse do atje, se ka më shumë liri, pastaj atje është dhe Dritëroi. Është rritur në gjunjë të tij. Vërtetë të bën shumë për të qeshur. Ajo qeshi dhe sytë iu mbushën me lot. Ah, këta fëmijët e familjeve të nomenklaturës! Vetë isha një i deklasuar i rrezikuar për burg. Fati më kishte sjellë në Kinostudio. Ishte koha kur bëheshin 14-15 filma në vit dhe duheshin 20 skenaristë e redaktorë. Te Drita, thashë dhe unë, atje kam punuar një vit, ishte një përvojë e paharruar, se kishte të bëje me njerëzit më të shquar të letrave. Kaq. Ajo pothuaj e kishte ndaluar të gjithë, regjisorë e skenaristë për t'iu marrë një mendim për Dorin. Tani që kanë kaluar shumë vite ai preokupimi i saj më duket fare i natyrshëm, ndërsa mllëfi im verban, krejt i pakontrolluar, unë harroja që isha një lloj renegati, s'kisha të bëja fare me atë shtresë, po ama do të punoja e, njëfarësoj, doja s'doja unë, do të shkrihesha me të. Xhanfizeja nuk më kishte paragjykuar, ndërsa unë krejtësisht. Dhe krejt mëndjelehtësisht u mësova që nga ajo pikë krejt vetjake ta shikoja dhe Dorin. Poezia e tij s'më bënte përshtypje në atë kohë, më dukej e lehtë, tradicionaliste, shkrimet gazetareske nuk shquheshin për ndonjë gjë të veçantë. Këta të "përkëdhelurit" kishin mbushur institucionet. Dhe e kisha harruar ndërkaq.

Po ja, erdhi takimi për librin tim. Një takim që mungonte. Sepse Dori nuk kapej. Krejt rastësisht e mbërtheva një ditë, lart te tryeza e tij fare e çrregullt, gati për t'ia mbathur. Dori, pimë një uiski bashkë? Buzëqeshi, më pa me atë fytyrë të hareshme prej turisti që po i ikën avioni dhe pranoi menjëherë. O, u kujtua në mes të rrugës, Zijai më kërkon sot librin tënd të redaktuar. Hoqi ca që e gjeti gati të hedhur në koshin e letrave, e mori ashtu të shkapërderdhur dhe me çoi në një kthinë pa njerëz. Zijai po më


duron shumë, s'i bëj dy pare punë, s'jam unë për këtu.. Megjithëse unë s'jam për askund..

Dëgjo, më tha, unë s'të kam lexuar asnjë tregim, dy reçencat i ke pozitive, Zijai e ka pëlqyer librin, kështu që mjafton firma ime. Vuri një firmë. U zhgënjeva, po s'foli. Ç't'i thoja, gjithçka që bënte e kishte të lindur, edhe këtë papërgjegjshmëri. Dëgjo, më tha, s'jam as poet, as prozator, po thjesht gazetar. Mund të bëhem një ditë gazetar. Prandaj as mos më kërko të t'i lexoj tregimet. Më ka marrë më qafë familja. Dua të dal prej saj, po s'dal dot. Jam rritur duke ju bërë shurrën në gjunjë njerëzve të mëdhenj me poste. Dy prindër të famshëm që e kishin mirë me regjimin, unë një teveqel i prapë që vetëm luaja, s'jam serioz, nuk ndihem mirë në asnjë punë, e nis me entuziazëm dhe ftohem menjëherë se nuk më pëlqen më.. bëj budallallëqe çdo ditë dhe s'heq dorë.. Kështu pra, ç'ke gabime brenda në dorëshkrim do të mbeten, se unë nuk kam ndërmend të merrem me tregimet e tua, po emrin redaktor do ta vë se dua të marr rrogën nesër.

Kështu u ndamë. Dhe kur ika, në vend që të haja veten me dhëmbë prej zhgënjimit, ndjehesha i lehtë dhe më vinte të qeshja se për herë të parë përballesha me një sineritet kaq të paskrupullt.

Pastaj Dori i braktisi miqtë e shtëpisë, ato gjunjët e shurrosur të nomenklaturës që i dha aq komoditet të shpëlarë jetes së tij dhe u mor me partitë, parlamentin, shtypin opozitar. Një djalosh i veshur gjithmonë me kostum, herë me mjekër, herë pa mjekër, gjithmonë duke nxituar, me një fytyrë kaq të delirë, hokatare, miqësore, sa të nxiste ta arrije dhe ta zije shok, po ai nxitonte dhe ti nuk e arrije kurrë. Dita dhe nata pa një ndarje, bar West, Amerika, Las Vegas, Guva e qetë, Noel.. me miq, me shumë miq të të gjithë krahëve politikë, me mikeshë të ëmbla që qeshnin me të sa mekeshin, pastaj

ai i linte papritur dha ata e kërkonin më kot..Ai e kërkonte vëmendjen dhe dashurinë, besnikërinë, po nuk paguante asnjë çmim. Dori jepej, kjo ishte mënyra për të afuar njerëz. Dori të shërbente në qoftë se besonte tek ty. E kam parë para parlamentit kur doli nga makina e tij dhe shkoi t'i hapte derën Sali Berishes dhe i shkoi nga pas dhe e bëri për të qeshur.. qeshte Sali Berisha me Dorin. Pse e bën, Dori, thashë me vete me një ndjenjë zhgënjimi. Por ai besonte lehtësisht dhe po aq lehtësisht hiqte dorë. Nuhaste dhe në ajër atë që do të ndodhte, nervozohet para kohe, ose dashurohet. Ai u zhgënjye nga politika. Sepse e njohu nga brenda. Dori ishte idealist tallës, kokëkrisur i thellë dhe hovardar dorështërngruar. Ai i harxhonte shpejt të vetat dhe kërkonte e kërkonte dhe askujt s'i rëndohej sepse ai ishte kamerier i dashurisë. Të sillte, gjithmonë të sillte dhe njerëzit u mësuan që ai t'u sillte. Po të shfaqej Dori do të bëhej pështjellim i madh dhe gjërat serioze do të merrnin rrokullimën. Ai ishte armik i seriozitetit prej interesit dhe mik i interesit per seriozitet, që se gjeti kurrë. Aq shumë u mësuan me Dorin hokatar, që i ngrinte vetes kurthe për ta kapur në gabime e faje, sa u bë i pabesueshëm. Atij s'i pëlqente asgjë dhe kërkonte që ta pëlqenin. Po e rrethoi vetmia midis miqve. Sepse miqtë kishin ambicie, veç shakave me të, donin shumë gjëra nga partitë, ndërsa ai tallej dhe, midis të qeshurave dhe mëndjelehtësisë vetëm në dukje, ai më në fund mbeti vetëm. Sepse ai nxitonte, jo për t'u ngjitur, po për të dalë. Ç'njeri i çuditshëm, Dori.. Dhe pikërisht në këtë rënie me vetëdije, ai u bë poet, shkrimtar, njeri. Lart ishte kotësia e idealeve, sepse luhej me to, poshtë ishte ideali me të cilin Dori u përfyt në shkrime, sepse nuk donte të luante me të. Dori është i sinqertë prandaj lexohet. Dori është i vërtetë prandaj lexohet. Besojini Dorit! Kjo më vjen të them ndërsa pëllumbi kullot qetësisht në dyshtemenë prej mermeri



të starbucksit. Në kohën kur Dori u vetëpërgjashtua ai u bë. Prej vuajtjes, zhgënjimit. Ai ishte në majë, te koka, po zbriti poshtë, te këmbët. Kur dhe pëllumbat nuk fluturojnë më në Manhatan, po kullosin te këmbët. Pëllumbat!

I çova një shkrim për një shkrimtar francez, që kishte bërë një film për kanunin dhe e kishin rrasur në burg në Durrës. Cizia Zykë, nje aventurier shume i njohur, që i ishte tekur të bënte filma. Shikasin kishin marrë informacion se ai ishte vrasës. Këto ishin nxjerrë nga librat e tij bestseller. Atë kohë Dori ishte kryeredaktor i gazetës Koha Jonë. Atje pata botuar për kafe ca shkrime për artistë të mëdhenj, të gjalle, krejt të harruar. Dori i kishte botuar, më kishte vënë honorarin më të kripur, po shkrimet s'mi kishte lexuar. Përsëritej historia e vjetër. S'lexoj gjë, ç'të lexosh, më thoshte, ku kam kohë unë.. As këtë shkrimin që më solle s'do ta lexoj.. Po do ta nxjerr që nesër. Kaq. Rrinte në këmbë dhe bënte shaka me mua. Natyrisht i kishte hedhur ca gota.


Pastaj i lexova poezitë. I lexova tregimet. Të mrekullueshme. S'kishin si bëheshin më të mira. Ia lexoja me një frymë sidomos tregimet. Bruto, kaq të vërteta sa të dukej se haje një grusht ballit. Ai nxitonte të shkruante dhe të botonte. Nxitonte dhe të pinte. Nxitonte dhe të bënte dashuri. Nxitonte dhe të harronte.. Khanfisen, nënën e tij madhështore. Ajo e kishte vështirë të dilte, s'i bënin këmbët, po Dori, kanakari i saj e kishte harruar. E kishte harruar vërtet, sepse ndjente që po ikte përgjithmonë. E dinte, po nuk e bënte fjalë, vetëm vazhdonte të kriposte shaka në dreka e darka pa kripë. Shkruante si nën një shenjë vetëtime. Mora rrugën, thotë Xhano, nga Pallati im te Flora në rrugë të Durrësit për te nëntë katëshet, pikërisht te kati i nëntë ku rrinte im bir. Do ta bëj rezil, oj, sa i çuditshëm është bërë! S'kishte as ashensor. U ngjit lart për dy orë, ulu e ngjitu nëpër shkallë, fëmijët se njihnin më. Fëmijët e lindur në kohën e demokracisë. S'dinin kush ishte ajo. Njëri e pyeti; Kush jeni ju? Shtriga te borëbardha me shtatë xhuxhët, do helmoj tim bir. Ja, molla. Dhe i kishte nxjerrë një mollë nga xhepi, një mollë jeshile. Jam ajo që ka bërë filmin; Beni ecën vetë. E ke parë, xhan? Fëmija kishte ngritur supet. Jo, nuk e njihnin. As fëmijët. As djali. Ç'kohë kishte ardhur! Atje, kur kishte hyrë brenda, ai, në tryezën e shkrimit, jo më Dori i parë, jo më. I ligur. Me një shishe uiski të pirë gati gjer në fund. Po ti, i kishte thirrur, mos ke marrë me qira një nënë tjetër? Dori i saj i ishte hedhur në fyt duke përmbysur tryezën. Dhe kishte qarë. Po s'i kishte thënë se do të vdiste shpejt. Dyzetë e ca vjeç. Do të vdiste.

Ajo kishte ndjerë se s'duhej të qante, po vetëm ta puthte atë harrakatin e saj siç nuk e kishte puthur kurrë. Zemra e nënës. Kushedi sa vrima do të ketë nga plumbat që ka marrë prej fëmijëve. Zemra e Dorit, dhe ajo me plot vrima, natyrisht.

Për herë të fundit e takova kur kishte dalë “Hollësi fatale.” Ma lexove librin? më pyeti. Ia ndjeva dridhjen në zë. E ke më të mirin. Ashtu mendoj dhe unë. Pastaj u qetësua. Hiç. Asgjë s'kam bërë, tha. Të mos kesh më kohë për të korigjuar. Për të bërë një tjetër. Dhe pastaj një tjetër, gjersa të kuptosh se s'ke bërë gjë. Dhe kur ta kuptosh këtë, t'ia hysh nga e para dhe të shikosh se je në fund dhe t'i bësh mutin. Ti s'ke shkruar më, më tha. Jo, s'kam shkruar më. I kisha botuar nja njezetë libra. Më mire, më tha, se do të më lëndojte me një ndjenjë faji. E di, ti s'me ke lexuar asgjë. Vërtet s'të kam lexuar asgjë. Dhe unë e doja Dorin dhe e pelqeja shumë. I tillë ishte. Aq i përsosur në këtë virtyt, sa e mori vdekja për vete pa i thënë njeriu sepse deri në fund ai u tall dhe duke qeshur dhe marrë veten nëpër këmbë shkroi tregimet më të bukura të brezit të tij dhe një poezi kaq fine dhe të ndjerë sa të vjen të porositësh një requiem te një Mozart i ri për Dorin.

Dola nga Starbucks po ai pëllumbi s'ishte më. Dhe më mbeti mendja te ai pëllumbi që s'ishte më, edhe kur veshja xhaketen me inicialet e Oficer Security dhe nisa të ruaja Manhattanin, si një nga ata që s'kishin ruajtur dot Dorin.

Nju Jork, 2010



LETRA QË I NDRYSHOI JETËN EMILY DICKINSON-IT

Martha Acmann

Kur ishte në udhëkryq ajo kërkoi këshillën e një shkrimtari tjetër

Më 15 Prill 1862, Emily Dickinson nuk u ul të shkruante letrën më të rëndësishme në historinë e letrare amerikane. Por shumë studiues besojnë se këtë bëri. Në Amherst, Massachusetts, me shkollimin e përfunduar dhe fillimin e një jetë të veçuar nga bota, Dickinson-i ishte në një udhëkryq. Tashmë kishte kohë që shkruante seriozisht poezi. E kishte përzemër shkrimin e vargjeve nëpër broshura të vogla, shkruante 20 ose më shumë poezi nëpër letra të palosura, të cilat i vendoste mbi njëra-tjetrën dhe pastaj u ngjiste anët.

“Fashikuj,” i quajti më vonë një redaktor. Me mbi 400 poezi të shkruara, disa të lexuara mes miqsh dhe në familje, disa të botuara në mënyrë anonime në gazeta, 31 vjeçarja Dickinson vriste mendjen nëse ishte e gatshme të dilte para publikut ose të paktën të kontaktonte dikënd që mund t'i jepte një mendim.

Një *Atlantic Monthly* i kishte tërhequr vëmendjen një artikull. “Letër për një kontribues të ri” nga eseisti Thomas Wentworth Higginson-i u jepte këshilla shkrimtarëve të mundshëm që kërkonin të botoheshin. Sugjerimet e Higginson-it ishin të larmishme, nga ato praktiket (përdorni pena të mira, bojë të zezë dhe letër të bardhë) deri



tek më seriozet (“Mund të ketë vite plot pasion një botë dhe gjysmë jete në një fjalë”.) Edhe pse rrallë shkëmbente letërkëmbim me dikë që nuk e njhte, diçka brenda saj e shtyu t’i shkruaj.

Javë më parë, qyteza e Amherst-it kishte pësuar një goditje të tmerrshme. Frazar Stearns-i, djali i shtrenjtë i presidentit të kolegjit *Amherst*, ishte vrarë në betejë. Dickinson-i pa të vëllanë që u pikëllua nga kjo. “Ai vazhdon të përsëris, “Frazeri është vrarë, Frazeri është vrarë”, ashtu si i tha Ati – Atij” shkruante ajo. “Dy-tre fjalë plumbi e tronditën dhe bëhen gjithnjë e më të rënda”. Një nga shokët e klasës së kolegjit, ndërtoi një arkivol me dërrasat e fushë-betjës dhe lundroi gjashtë milje nëpër lumin Neuse në det të hapur drejt luftanijeve të Unionit. I qëndroi afër trupit të Frazar-it derisa arriti në Amherst, ku William Augustus Stearns-i s’mundte dot ta shihte trupin e të birit 21-vjeçar.

Fitorja e Unionit në New Bern, Karolina e Veriut në mars 1862 ishte vendimtare për “Djemtë e Amherst-it”, një regjiment i udhëhequr nga ish profesori i kimisë William Clark. Pasi trupat u vunë në zotërim të një topi të Konfederatës, gjeneral brigade Ambrose Burnside kërkoi që ai të dërgohej në Amherst si shenjë mirënjohje për sakrificën e Stearns-it dhe të tjerëve. Më vonë kolegj mbahti një ceremoni dhe babai i poetes mbahti një fjalim. Edward Dickinson-i vuri në dukje se të gjitha jetët përfshihen nga dallga e historisë. Në këtë çast prekës, tha ai, individët janë të lidhur me ngjarjet që i rrethojnë me anë të “shoqërive të shenjta”.

Të nesërmen, pranvera dha shenja se po vinte. Në ditarin e përditshëm ku përshkruante motin, profesori i Kolegjit Amherst Ebenezer Snell shkroi që ngrica e tokës më në fund kishte shkrirë. Retë u shpërndanë në qiell dhe në pellgjet rreth qytezës

bretkosat filluan korin e tyre sezonal. Emily s’ishte ndjerë asnjëherë aq e gatshme për t’ia paraqitur veprën e saj botës. Ndoshta fjalët e të atit për “shoqëritë e shenjta” e nxitën. Ndoshta e kuptoi që lexuesit të cilëve u kishte besuar, kushërinjtë, kunata dhe miqtë, ishin të zënë me jetët e tyre dhe s’kishin kohë për të si dikur. Numri në rritje i vdekjeve të luftës dhe vetëdija gjithnjë e më e fortë se jeta mund të ndryshonte për një çast, e elektrizoi qenien e saj. Edhe patriotizmi mund të ketë luajtur rol. “Kjo letërsi amerikane që kemi ne do të jetë nesër klasike, nëse ne bëjmë tonën”, kishte shkruar Higginson-i në *Atlantic*, “Nëse, detyra ju thërret dhe mundësia ju jepet, shiheni si një privilegj për të bërë atë që u takon”.

Dickinson-i i pa edhe një herë të gjitha poezitë, dhe përzgjodhi katër: “Luajmë kinse margaritarin”, “T’rrëfej si dielli lindi”, “Më afërta ëndërr prapsohet-e pakryer” dhe “Ndore në ato oda alabastri” (Përktheu Arben Dedja). Ajo nxori një letër tjetër dhe shkroi.

Zoti Higginson,

Ajeni shumë të zënë për të më thënë nëse Vargjet e mia janë gjallë?

Mendja është aq afër vetvetes – s’mund ta kuptoj, e di që s’mundem-dhe s’kam çfarë të të pyes -

A mendoni se vargjet marrin frymë - dhe a keni kohën e lirë për të ma thënë, do t’u isha sakaq mirënjohëse -

Nëse bëj gabim – sepse guxuat të më thoni - do të më bënte të ngjallte vërtetë nderim-kundrejt jush-

Bashkangjes emrin tim - duke ju pyetur, nëse mundeni - Zotëri - të më tregoni cila është e vërteta?

Se nuk do të më tradhтони - është e panevojshme ta kërkoj - meqenëse nderimet janë peng i vetvetes -


Kur Thomas Wentworth Higginson-i mori letrat e mbërritura nga zyra postare e Worcester-it, Massachusetts, atij ngjalli kureshtje njëra prej tyre. S’kishte asnjë nënshkrim, por brenda ishte një zarf më i vogël, dhe e shkruar mbi letër ishte emri i Dickinson-it. Lexoi poezitë dhe i ktheu përgjigje. Do të kalonin tetë vjet derisa Thomas Wentworth Higginson-i dhe Emily Dickinson-i u takuan ballë për ballë, por marrëdhënia e tyre e cila filloi me atë letër të rëndësishme do t’u ndryshonte jetët.

Higginson-i kuptoi shpejt se ishte më mirë të mos i jepte këshilla. Ajo e njhte mendjen e vet më mirë se kushdo tjetër. Por meqë s’ia ofronte dot kritikën letrare, i ofroi miqësi të përhershme dhe një interes të paseshtur për terrenin e egër të mendjes së saj. Kur ajo vdiq në vitin 1886, ai udhëtoi për në Amherst për t’i lexuar në funeral një poezi Emily Brontë. Më vonë, pasi motra e Dickinson-it gjeti dhjetëra fletë me poezi të stivosura mbi njëra-tjetrën, future në sirtarin e dollapit, ajo e kontaktoi. Higginson-i dhe bashkë-redaktori Mabel Loomis Todd filluan punën, dhe më 1890, vëllimi i titulluar “Poezi” filloi udhëtimin në botë.

Gjatë pjesës tjetër të jetës, Higginsoni vazhdoi të mendonte për atë letër të pare, me rreshtin e parë shpërthyes, vizat, sintaksën e ndërprerë dhe zarfin brenda zarfit. Por mund të ketë qenë ajo fjala “e gjallë” në fjalinë e parë që nuk iu shqit kurrë nga mendja.

Kur fati i takoi dy më 15 Prill 1862, Emily Dickinson-i nuk e pyeti nëse vargu i saj ishte “i botueshëm” ose “i mirë”. Ajo e dinte tashmë, apo jo? Ajo e kuptoi që poezia duhej të udhëtoj, duhej të ishte e brendshme, dhe duhej të gjente rrugën e saj në trupat tanë. Në atë ditë të butë pranvere, ajo ndërmori hapin më të pashembullt të jetës së saj. Letra për Thomas Wentworth Higginson-in ndryshoi rrjedhën e letërsisë amerikane dhe na mësoi që poezitë e mëdha duhet të marrin frymë. Për të goditur në shenjë, Dickinson-i e dinte se poezia duhej të ishte e vetëdijshme, e gjallë, dhe me mundësinë për t’iu shfaqur botës.

Përktheu: GRANIT ZELA



-In memoriam për Ndoc Gjetjen, në 10 vjetorin e vdekjes-

GJITHMONË DIKUSH KUJTOHET PËR POETËT ...

Salvador Gjeçi

Kur Ndoci u rëndua shumë nga shëndeti, i shkonim në shtëpi dhe e merrnim për kafe. Të shumtën e herëve shkoja me Pashk Vathin.

(Pashku është një lexues sqimatarë i poezisë, ndër personat e rrallë që i tregon aq bukur barcaletat, madje ka shkruar një liberth të vogel xhepi me barcaleta. Punon në polici. Është pasionant i filmimeve me kamera. Një përputhje krejt e pazakontë e profesionit me pasionet e një njeriu.) Pikërisht kjo e bën më karakter dhe më interesant.

E ndjenim se sëmundja e Ndocit nuk do të kishte përmirsim. Një ditë të bukur me diell e morem të dilnim për një shëtitje buzë detit, në Shengjin. Mbanim me vete në makinë një kamer dhe një aparat fotografik. Patem bërë një plan, por nuk i thamë asgjë deri kur mbërritëm atje. Kishim pak frikë se mos nuk pranonte të filmohej. Ai nuk ishte përsosur që bënte veprime për tu dukur. Kur i pa aparatet vetëm buzqeshi. Në një farë mënyre Pashku e kishte përgaditur terrenin. Si mjeshter i bisedave të mençura dhe plot humor nuk i la të kuptonte se e kishim thirrur enkas për ta filmuar. Nga Lezha në Shengjin zymtia e portretit të tij ishte çelur. Ne i kishim marrë aparatet por nuk kishim ndonjë ide apo skenarë të përgaditur. Nisëm të ecnim buzë detit, për nga pylli i Vainit. Unë vetem shkrepja aparatin fotografik. Përpiqesha ta gjeja sa më në befasi. Pashku e filmonte në ecje buzë detit. Fokusonte vështrimet e tij, lëvizjen e reve në horizont, shkumzimet e dallgëve. Filmonte gjurmët e këpucëve në rrë, valzat që ia fshinin gjurmët. Përpiquej të kapte ndonjë pulbardhë, ndonjë zog në fluturim. E filmonte përballë dhe me shpinë, në ardhje e në ikje. Diku ndeshem një cung me rrënjë të qëruara nga uji i kripur. I thamë të ulej e të pushonte pak. Ashtu me atë portret ëndërrimtar, me mjekerr e flokë të gjata që ia shpupuriste era, të jepte përshtypjen e një anijehumburi, i dalë në breg nga rastësia. Të ngjante me një legjendarë të kohëve të largëta, me një Uliks të rraskapitur nga udhët e gjata. Portreti i tij të bënte ta shetisje gjithandej imagjinatën për të gjetur krahasim pa fund për të. Mbi atë cung gjithë rrënjë, të bëhej se ngjasonte me një krijesë mitologjike gjysem njeri, gjysem pemë, me rrënjë shekullore. Në pyllin pranë sapo kishin nisur të shpërthenin bulzat e gjetheve. Gjithë vija e bregut ishte vetem e jona. Nuk kishim asnjë ngutje. Pashku e kryesonte bisedën ndërsa Ndoci qeshte me gjithë shpirtë. Një çast Pashku nisi fjalinë e parë të një barcalete.

- Jo, pash zotin këtë mos e thuaj. Dhe e qeshura shpertheu, sepse na e kishte

treguar edhe herë të tjera. (Barcaletë me pullë të kuqe) Pritem sa u çlodh. Kur nisem prap të ecnim, Pashku i thirri,

- Mblidhi dy tri guacka, ta kemi një plan ndryshe. Ndoci i qeshi dhe ia plotësoi dëshirën.

- Mos më thuaj të vizatoj zemra e të shkruaj në rrë!

- Për shpirtë do të doja të shkruash një poezi me një tri strofa, me një kusht që të jesh bashkautor me një poete, jashtë kameres. Ndoci qeshte dhe i rrezatonte një sineritet fëmije. I kuptonte mirë bisedat e batutat e koduara të tij.

Kur po i afroheshim pyllit të Vainit nisi t'i ndjehej prap lodhja. Pranë një pishë të vjetër kishte mbetur një copë trung frashri i prerë që nga vera e shkuar. Aty Ndoci u ul. U mbështet pas pishës që qëndronte në këmbë si një monument i lashtë. Pashku nisi prap me barcaletat. Nuk donte t'i linte kohë ta përjetonte lodhjen. Kur nuk mbushej dot me frymë, ai nxirrte nga çanta një pompë që e spruonte thellë në gojë.

Ashtu i mbështetur, më ngjante me Naimin me liber në dorë. Sa shumë ngjasojnë poetët me njëri-tjetrin, por edhe me pemët. Pisha dykrahëshe ku qe mbështetur Ndoci ishte e këputur në njërin krah, ndërsa krahut tjetër pothuajse i kishte humbur gjelbërimi. Përgjatë trungut të sajë ishte çelur

një plagë që kullonte. Rreth një meter mbi tokë, një gropthë e çelur prej një teh sopate kishte mbledhur aty një grusht rrëshirë. Sa i ngjasonte Ndoci kësajë pishë. Prej plagëve e dhimbjeve i rridhnin vargjet e tij në gropthen e kraharorit, pas vitit të mbrapshtë, 1997, që i mori djalin.

Ecnim nëpër rrë, në një zonë plot me cungje e rrënjë pishash të rrënuar nga deti. Nuk e kishim pritur që ai të ishte aq i gatshëm për të na lejuar ta komandonim, sikur ne të ishim ndonjë ekip nga ata të RTSh-së. Ishte i vetdijshëm se ato filmime dikush do ti shihte edhe pse ne bënim sikur filmonim thjeshtë për kënaqisinë tonë.

Ndoci kishte qënë për pesëmbëdhjet vjet kryeredaktori i revistës "SKENA DHE EKRANI" Askush nuk qe kujtua të bënte një dokumentarë të mirfilltë për të. Ndërruam disa herë vend për të gjetur peizazhe sa më të bukura. E lamë regjistrimin vetem kur u shkarkua bateria e kameres. I hypëm makines dhe u ndalem në një restorant peshku në fund të portit.

- Sa do të doja t'ju kisha në një plan edhe me Rudolfin e Preçin!

- Rudolfi është larg. Më ka thënë se në Lezhë ndalem vetem për ty, nuk i ka mbetur më asgjë në Lezhë.

- Ai nuk e di se këtu e duan edhe ata që ai nuk i njeh, prandaj ndalet vetëm për ty... Në ksi lloj bisedash e mbyllem atë ditë.

Prej kohësh Pashku kishte mbledhur disa kronika pikante ku shfaqej Ndoci në veprimtari të ndryshme. E kishte filmuar nëpër promovime librash. Mblodhi nga miqt e tij edhe disa intervista që flisnin për të. Filmimeve të bëra atë

ditë në bregun e detit u kishte montuar muzikë dhe poezi të lexuara. Pak nga pak kishte marrë formë një përmbledhje me filmime mjaft domethënëse nga jeta e tij.

- Kam përgaditur dokumentarin që t'ia bëjmë surprizë Ndocit me rastin e 60 vjetorit,- më thotë Pashku një ditë. Ishte i lumtur. Kishte besim se kishte bërë një punë të mirë. Mezi priste ditën që ta shihnim të gjithë së bashku.


...Prej dhjetë vjetësh, në çdo veprimtari në kujtim të poetit Ndoc Gjetja, qoftë nga miqt e tij, qoftë nga institucionet zyrtare, përdoret ajo përmbledhje me filmime bërë me aq pasion e dashuri nga Pashk Vathi, mik i vertetë i Ndocit, dhe i krijuesve në Lezhë.

Jo rrallë i bie telefoni Pashkut: "Na duhen ato filmimet tua, kemi një aktivitet për Ndocin, të lutem!"

Ajo kasetë tashti është shumfishuar. Shkojnë e vijnë drejtuesit e institucioneve aty në Lezhë, dhe me pak ndryshim në montazh, të gjithë e përdorin pa ia përmendur autorsinë. Asaj përmbledhje me filmime, Pashku nuk qe kujdesur t'i vendoste as titra as sigla autorsie, nuk e vuan aspak këtë pjesë. Është i lumtur që kujdesi i tij i atëhershëm sot merr vlera përherë e më shumë.

Kushdo që ka kuriozitet për ta njohur Pashkun, do të habitet kur ta takojë të veshur me uniformën e policit, që jep leksione nëpër shkolla (për parandalimin e kriminalitetit) me një rregullsi e seriozitet të admirueshem.

Por nëse do ta takoni të veshur civil, keni për të qeshur me gjithë shpirtë me bisedat, rrëfimet, me barcaletat dhe me humorin e tij brilant.



FATOS KONGOLI

Kapitulli i Amerikës



BOTIMET
TOENA